



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 23 03 / Prot.  
A

Tiranë, më 22. 12. 2025

VENDIM

Nr. 3, Datë 22 12 / 2025

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË PUNËS PËR VITIN AKADEMIK  
2024-2025, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të nenit 32, pika 1 dhe të nenit 49, pika 1, germa "h" të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018 "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afati për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, të Udhëzuesit të AKFAL Nr. 75/3 Prot., datë 11.07.2023 "Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë të Sportit dhe Arsimit" të AKFAL, pranë MAS, si dhe të nenit 48, pika 1, germa "m", me titull "Funkcionet e Bordit të Administrimit të UART" dhe nenit 147, me titull "Raportimi" të Statutit të Universitetit të Arteve, Bordi i Administrimit, në mbledhjen e përbashkët me Senatën Akademik, pas diskutimit dhe me votim të hapur,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin vjetor të punës për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin e Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca si dhe një kopje t'i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**BORDI I ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

Prof. Besnik Bisha

Anisa Pollo

  
\_\_\_\_\_  
(Kryetar)

\_\_\_\_\_  
(Anëtar)


**Etjola Kola**

---

(Anëtar)

**Prof. Asoc. Dr. Sokol Saraçi**

---

(Anëtar)

**Oltjon Muzaka**

---

(Anëtar)

**Lorenc Vangjeli**

---

(Anëtar)

**Vladimir Llakaj**

---

(Anëtar)



## RAPORTI I VEPRIMTARSË VJETORE 2024–2025 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

**Raporti Vjetor i Universitetit të Arteve (UART) për vitin akademik 2024–2025** është përgatitur nga njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë dhe sektorët e institucionit. Raporti është strukturuar sipas çështjeve të kërkuara, fushave dhe kompetencave përkatëse, bazuar në Udhëzuesin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) 2023.

Raporti vjetor bazohet në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, konkretisht në:

- **Ligjin nr. 80/2015**, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në veçanti nenin 32, nenin 38 pika 1 germa “g”, nenin 39 pika 12, si dhe nenin 49 pika 1 germa “h”;
- **Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 5, datë 19.02.2018**, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, i ndryshuar;
- **Udhëzuesin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) pranë MAS**, “Për modelin e raportimit vjetor të IAL-ve, në zbatim të Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit”;
- **Statutin e Universitetit të Arteve**, përkatësisht: neni 24 “Funksionet e Senatit Akademik të UART”, neni 27 “Funksionet e Rektorit”, neni 29 “Rektorati”, neni 30 “Komisionet e Përhershme”, neni 48 “Funksionet e Bordit të Administrimit” dhe neni 147 “Raportimi”.

Raportimi synon të paraqesë informacione të qarta dhe transparente mbi veprimtarinë e Universitetit të Arteve, në zbatim të misionit të tij dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Ky raport ofron informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies, kërkimit artistiko-shkencor dhe veprimtarive krijuese, si dhe mbi gjendjen financiare të UART. Gjithashtu, raporti përfshin të dhëna mbi angazhimin e personelit akademik, tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2024–2025, gjurmimin e studentëve si dhe elementë të tjerë që lidhen me shërbimet e ofruara nga Universiteti i Arteve.

Analiza e paraqitur në këtë raport vjetor synon të nxisë dhe të rrisë përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe sigurinë e cilësisë së shërbimeve që ofron UART. Njëkohësisht, raporti evidenton problematikat e konstatuara gjatë vitit akademik 2024–2025, me qëllim adresimin dhe zgjidhjen e tyre në bashkëpunim me strukturat shtetërore përgjegjëse në fushën e arsimit.

Të dhënat e këtij raporti janë miratuar në mbledhjet e **Senatit Akademik** dhe të **Bordit të Administrimit** të Universitetit të Arteve.

Raporti paraqet në mënyrë të përmbledhur informacione, analiza dhe gjetje lidhur me: funksionimin dhe performancën e strukturave përgjegjëse (organe kolegjiale, komisione të përhershme) në aspektet akademike dhe financiare; procesin e mësimdhënies dhe të nxënies; njohuritë dhe kompetencat në nivel njësisht kryesore; projektet ku personeli i UART merr pjesë si palë aktive; përqindjen e të diplomuarve; numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar dhe të diplomuar sipas niveleve dhe programeve të studimit; mbështetjen për studentët (bursa, përjashtim apo reduktim tarifash); pjesëmarrjen e studentëve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

në projekte bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar; mbështetjen për lëvizshmërinë studentore; si dhe vlerësimin e cilësisë së studentëve për secilin cikël dhe program studimi.

Raporti pasqyron gjithashtu mobilitetin e personelit akademik në kuadër të projekteve, përmbushjen e standardeve shtetërore akademike dhe infrastrukturore në përputhje me Kodin e Cilësisë, duke përfshirë mjediset didaktike dhe artistiko-kërkimore, politikat e shpërndarjes së fondeve, infrastrukturën informatike në funksion të mësimit, si dhe pagesat për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore.

Në mbledhjet e organeve kolegjiale dhe drejtuese janë ndjekur procedurat dhe protokollet e përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Universiteti i Arteve ka si prioritet forcimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë, i reflektuar edhe në krijimin dhe miratimin e një strukture të posaçme për këtë qëllim. Nga burimet në dispozicion konstatohet përgjegjshmëri në përmbushjen e detyrave nga strukturat përkatëse.

Kurrikulat që ofron Universiteti i Arteve, Tiranë, janë të lidhura ngushtësisht me kërkesat e profileve përkatëse dhe mbështeten nga një staf akademik i kualifikuar. Programet e studimit janë të përcaktuara qartësisht dhe të përshtatshme me tregun e punës, në përmbushje të misionit të UART për ofrimin e një arsimimi gjithëpërfshirës dhe kualifikimit artistik të studentëve.

Funksionimi i organeve kolegjiale dhe drejtuese është realizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Çdo njësi, strukturë, personel akademik, ndihmës-akademik dhe joakademik është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurave dhe veprimtarive të Universitetit të Arteve.

Senati Akademik ka ushtruar kompetencat e tij gjatë gjithë vitit akademik përmes vendimeve të marra në mbledhjet përkatëse, të adresuara njësisë përgjegjëse për zbatim. Bordi i Administrimit ka ushtruar kompetencat e veta në drejtimin e veprimtarisë financiare të UART. Rektorati dhe dekanatet, si organe kolegjiale, kanë marrë vendime lidhur me strukturën e vitit akademik, komisionet për monitorimin e konkurseve të pranimeve, regjistrimeve, transferimeve dhe cilësisë së mësimdhënies. Janë propozuar dhe miratuar gjithashtu grupe pune dhe komisione të posaçme në nivel universiteti.

Këshilli i Etikës, si organ kolegjial, nuk ka pasur raste të adresuara lidhur me shkelje të normave morale apo etike gjatë vitit akademik. Njësitë administrative dhe ndihmëse akademike kanë zbatuar vendimet e organeve kolegjiale dhe drejtuese në ushtrim të kompetencave të tyre.

Universiteti i Arteve përbëhet nga **Rektorati, Fakulteti i Muzikës, Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura.**

Fakulteti i Muzikës përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Interpretimit;
- Departamenti i Kompozicionit, Muzikologjisë, Dirigjimit dhe Pedagogjisë;
- Departamenti i Kantos.

Fakulteti i Arteve të Bukura përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Pikturës;
- Departamenti i Skulpturës;
- Departamenti i Arteve të Aplikuara.



Fakulteti i Artit Skenik përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Aktrimit dhe Teorisë së Artit;
- Departamenti i Regjisë dhe Regjisë së Filmit & TV;
- Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë.

## A. SENATI AKADEMIK

- a) **Informacion mbi realizimin e qëllimeve dhe objektivave të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit. Raporte të vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor. Raporti specifikon strukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse për këto realizime me referencë planin strategjik afatgjatë dhe afatshkurtër të IAL-së.**

Ky informacion paraqitet në formë përshkruese dhe tabelare, duke mbajtur në konsideratë minimalisht sa më poshtë:

- Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies
  - Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.*
  - Sstrukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.*
- Qëllimet dhe objektivat e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit.
  - Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik.*
  - Sstrukturat përgjegjëse dhe afatet përkatëse.*
- Të dhëna të përgjithshme në lidhje me raportet e vlerësimit të mësimdhënies, të nxënies, si dhe të kërkimit shkencor.

Raporti vjetor i Universitetit të Arteve është ndërtuar mbi bazën e Raporteve vjetore të të tre fakulteteve të tij: Fakultetit të Muzikës; Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Artit Skenik, si dhe mbi raportet vjetore të Drejtorivë përbërëse të UART (Drejtoria e Burimeve Njerëzore/SJIP\_A; Drejtorisë Ekonomike dhe Investimeve; Biblioteka e UART) si dhe Sektorit Mësimor, Kurikulës, Informimit të studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni dhe Sektorit të Projekteve Artistike dhe Shkencore.

Raporti vjetor për mësimdhënien është mbështetur kryesisht në të dhënat e tre Fakulteteve të tij. Ky raport për vitin akademik 2024-2025 synon të paraqesë një pasqyrë të plotë dhe të strukturuar të aktivitetit akademik, kërkimor dhe krijues të UART, duke reflektuar realizimin e objektivave të mësimdhënies, kërkimit artistiko - shkencor, bashkëpunimeve ndër-institucionale dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve. Ky raport vlerëson arritjet dhe sfidat e ndërmarra gjatë vitit akademik dhe identifikon fushat prioritare për përmirësim, duke u bazuar në standardet e Kodit të Cilësisë dhe planet strategjike të Universitetit të Arteve.

Përgjatë vitit akademik 2024-2025 UART ka vazhduar të ofrojë formim të lartë artistik dhe shkencor, nëpërmjet ndërthurjes së studimeve teorike dhe veprimtarive kërkimore artistike-shkencore duke zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e kulturës dhe artit në vend e më gjerë. Universiteti i Arteve ofron 70 programe studimi prej të cilave 35 janë programe të ciklit të parë, ku studenti siguron diplomën Bachelor, 32 janë programe të ciklit të dytë, në përfundim të të cilave studenti pajiset me diplomë Master (ku 1 program është Master i Shkencave, 4 Master Profesional dhe të tjerët Master i Arteve) dhe, më në fund, 3 (tre) programe të Ciklit të tretë të cilat përqendrohen në kërkimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

shkencor në fushën e arteve (muzikë, arte skenike dhe arte të bukura), ndërkohë që kandidatët të cilët përfundojnë veprimtarinë kërkimore pajisen me gradën shkencore “Doktor”. Të gjitha programet e sipërpërmendura, përveç doktoratës në “Arte Pamore”, janë programe egzistuese të cilat ofrohen prej disa vitesh në Universitetin e Arteve. Ndërkohë, programi i doktoratës në “Arte Pamore” është hapur në vitin akademik 2024-2025 duke plotësuar tashmë edhe Fakultetin e Arteve të Bukura me ciklin e tretë të studimeve. Përmes pjesëmarrjes aktive në projekte ndërkombëtare, shkëmbime akademike dhe veprimtari kërkimore, Universiteti i Arteve ka forcuar kapacitetin e tij institucional dhe ka rritur vizibilitetin ndërkombëtar.

#### a. Qëllimi dhe Objektivat e mësimdhënies:

Qëllimi i Universitetit të Arteve në lidhje me mësimdhënien është të sigurojë që të gjithë studentët të përfitojnë nga cilësia e lartë në mësimdhënie përmes plotësimit të nevojave të tyre, në përputhje me kërkesat e shoqërisë, tregut sikurse dhe specifikat e programeve të studimit që ofrohen në Universitetin e Arteve. Sikurse dhe në vitet e kaluara akademike, po ashtu për vitin akademik 2024-2025, ofrimi i mësimdhënies u zbatuar në përputhje me Planin e Zhvillimit Strategjik të Universitetit të Arteve 2018-2025, miratuar me VSA Nr. 15/1, datë 24/10/2017. Programet e studimit i janë nënshtruar rishikimeve për t’ju përgjigjur kërkesave të tregut të punës sikurse dhe për të qenë në koherencë me institucionet homologe në mbarë botën. Realizimi i mësimdhënies është realizuar duke ndërthurur metodat teorike me ato praktike. Shpërndarja e ngarkesës mësimore, për vitin akademik 2024-2025, është realizuar në përputhje

me Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018 *Për Veprimtarinë dhe Ngarkesën Mësimore të Personelit Akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë*.

Studenti, sipas programeve specifik të studimit, është mbështetur nga pedagogët për të ndjekur zhvillimin e punës artistike, kërkimore dhe shkencore, në funksion të përmbushjes së objektivave për çdo program studimi sikurse dhe të arritjeve individuale artistike/shkencore. Përgjatë vitit akademik 2024-2025 gjatë zhvillimit të procesit mesimor janë marrë në konsideratë:

- a) Metodot e mësimdhënies që zhvillojnë motivimin dhe dëshirën tek studentët për mësimin dhe realizimet artistike duke e bërë procesin mesimor sa më tërheqës;
- b) Organizimi i procesit mesimor është strukturuar në mënyrë të tillë, qoftë në aspektin teorik apo qasjen praktike, që të lehtësojë transferimin e njohurive teorike dhe modelimin e zgjidhje të problemeve, bazuar në shembujt individualë;

#### a.1 Realizimi i objektivave krahasuar me planin strategjik

Gjatë vitit akademik 2024–2025, procesi mesimor në Fakultetin e Muzikës; Fakultetin e Arteve të Bukura dhe Fakultetin e Artit Skenik, është zhvilluar në përputhje me planin strategjik afatshkurtër dhe afatgjatë të UART, me bazë ligjore Udhëzimin Nr. 29, datë 10.09.2018, të ndryshuar dhe aktet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, aktualisht Ministria e Arsimit. Struktura vjetore e procesit mesimor ka filluar më 06.10.2024 për Ciklin I Bachelor dhe Ciklin II (viti II Master), si dhe më 21.10.2024 për Ciklin II (viti I Master). Programet e studimit janë zhvilluar sipas planeve mësimore dhe syllabuseve të miratuara me Vendim të Senatit Akademik, ndërkohë që për të mundësuar një prezantim sa më të mirë dhe konkret të ofertës akademike në Universitetin e Arteve, për herë të parë, u organizuan edhe “Ditët e



Hapura” përgjatë të cilave u prezantuan ambientet dhe programet e studimit që ofron Universiteti i Arteve, event ky që siguroi mjaft interes nga të rinjtë, kryesisht të shkollave artistike, në kryeqytet e më gjerë.

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se, në përputhje me Planin Strategjik 2018-2025, i cili parashikon përshtatjen e mëtejshme me tregun e punës, në vitin akademik 2024-2025 janë diplomuar edhe studentët e parë në programet e hapura rishtazi në Ciklin I, për studime në “Muzikë Jazz” me urdhërin Nr. 382, datë 08/07/2022 dhe “Perkusion” me urdhërin Nr. 381, datë 08/07/2022.

Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes së mëtejshme për kërkime artistike/shkencore sikurse dhe të zgjerimit të ofertës akademike, mbas hapjes dhe aktivizimit të programeve të doktoratës në “Muzikologji”, pranë Fakultetit të Muzikës dhe asaj në “Arte Skenike” në Fakultetin e Artit Skenik, në vitin akademik 2024-2025 nisi procesin akademik edhe programi i doktoratës në “Arte Pamore”, hapur me Urdhërin e MAS Nr 668, datë 05.12.2023 administruar nga Fakulteti i Arteve të Bukura. Të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2024-2025 kanë qenë aktive përveç 7 programeve në ciklin BSC në Fakultetin e Muzikës (Kontrabas, Kitarë, Oboe, Fagot, Trombë, Trombon, Bastubë).

**Tabela nr.1: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e mësimdhënies**

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e mësimdhënies						
Nr.	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivite dhe detyrat konkrete	Fakulteti/ Drejtoria/ Sektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Zbatimi i planeve mësimore dhe syllabuseve të miratuara	Zhvillimi i leksioneve, seminareve dhe orëve praktike sipas planeve mësimore; respektimi i orareve dhe kalendarit akademik; monitorimi i realizimit të objektivave mësimore	Fakulteti i Muzikës; Departamentet; Stafit Akademik	I realizuar	Gjatë vitit akademik	Procesi mësimor është zhvilluar në përputhje me syllabuset e miratuara dhe aktet nënligjore në fuqi
2	Garantimi i cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimi profesional i stafit akademik	Përfshirja e stafit në veprimtari artistike, shkencore dhe trajnuese; reflektimi i përvojës profesionale në procesin mësimor; vlerësimi	Fakulteti i Muzikës; Dekanati Fakultetit	I realizuar pjesërisht	Gjatë vitit akademik	Nevojitet rritje e trajnimeve të strukturuar dhe shkëmbimeve akademike ndërkombëtare



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

		periodik i punës akademike				
3	Modernizimi i procesit mësimor dhe rritja e angazhimit të studentëve	Përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies; integrimi i praktikës artistike dhe veprimtarive jashtë auditorit; përditësimi periodik i programeve të studimit	Fakulteti i Muzikës; Departamentet; Komisionet Kurrikulare	Process ne vazhdim	Vazhdon	Nevojiten burime financiare dhe njerezore per te permbushur standartet dhe pershpejtuar ritmin e realizimit
4	Rishikimi i Planeve Mësimore të Programeve të studimit Bachelor i vitit akademik 2024-2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
5	Rishikimi i Planeve Mësimore të Programeve të studimit Master, i vitit akademik 2024-2025	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
6	Hartimi, rishikimi dhe miratimi i sylabuseve të lëndëve për çdo Program Studimi.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
7	Pasqyra ngarkesës mësimore të personelit akademik të Programeve të Studimit Bachelor në orë mësimore vjetore, viti akademik 2024-2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
8	Pasqyra ngarkesës mësimore të personelit akademik të Programeve të	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	Studimit Master në orë mësimore vjetore, viti akademik 2024-2025.					
9	Orari mësimor vjetor i Programeve të studimit Bachelor dhe Master 2024 - 2025.	Ndiqet cdo ditë	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
10	Realizimi i marrëveshjeve vjetore të stafit akademik me kohë të plotë 2024 - 2025 të Departamenteve	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Para Fillimit të vitit akademik	
11	Ndjekja për Konkretizimin e Marrëveshjeve dhe realizimit të Praktikave Profesionale (Bachelor) 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë vitit akademik	
12	Ndjekja për konkretizimin e marrëveshjeve dhe realizimit të Praktikave Mësimore (Master) 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë vitit akademik	
13	Ndjekje në vazhdimësi të procesit mësimor 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
14	Ndjekjen e konsultimeve dhe këshillimeve të studentëve 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
15	Ndarjen e udhëheqjeve të diplomave, tezave të diplomave, detyrave të kursit dhe të projekteve të kursit 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
16	Ndjekjen e kontrollit të dijeve, kolokiumeve, seminareve, provimeve 2024 - 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

17	Përgatitja individuale e stafit akademik 2024 – 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
18	Projektet artistike të stafit akademik me kohë të plotë, individuale dhe në bashkëpunim me FAS (shfaqje, filma etj) 2024 – 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë sezonit të provimeve	
19	Ndjekja e vijueshmërisë së kandidatëve të ciklit të tretë, doktoraturë 2024 – 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
20	Ndjekja e aktiviteteve krijuese artistike të stafit akademik 2024 – 2025.	po	Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamentet e tij	po	Gjatë gjithë vitit akademik	
21	Është planifikuar rritja e cilësisë së mësimdhënies nga ana e stafit pedagogjik, si dhe rezultateve të punës së studentëve në përgjithësi	Konkretisht është punuar me rritjen e bashkëpunimit mes stafit të vjetër dhe atyre të rinj, për përmirësimin e procesit të mësimdhënies në përgjithësi dhe angazhimit, sidomos të grupit të dytë.	FAB dhe Departamentet e tij	PO	Gjatë gjithë vitit akademik	
22	Është planifikuar rinovimi i literaturës, përmirësimi i procesit të punës individuale me studnetët për kuptimin, adresimin e problematikave, dhe promovimit të secilit drejt tregut të punës.	Gjithashtu është punuar intensifikisht me procesin e punës individuale me secili student për ritjen e performancës së tyre artistike.	FAB dhe Departamentet e tij	PO	Gjatë gjithë vitit akademik	



23	Është planifikuar dhe angazhimi i stafit në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, artistike e shkencore, të cilat synojnë përmirësimin e nivelit të tyre në përgjithësi.	Në fund të vitit akademik stafi drejtues i prog.të stud promovoi rezultatet më të mira me ekspozita.	FAB dhe Departamentet e tij	PO	Gjatë gjithë vitit akademik	
----	--	--	-----------------------------	----	-----------------------------	--

## ii. Fusha Kërkimi Shkencor dhe veprimtaria Krijuese dhe Inovacioni

Qëllimi i UART dhe Fakulteteve përbërëse të tij në fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarisë artistike është të promovojë një kulturë të vazhdueshme të eksplorimit artistik duke e integruar atë ngushtë me procesin mësimor si dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të stafit akademik. Stafi akademik me kohë të plotë, sikurse dhe ai me afat të caktuar, është njëherazi edhe krijues aktiv, i përzgjedhur nga radhët e profesionistëve të fushës që janë të lidhur ngushtë me tregun e punës dhe skenën artistike lokale e kombëtare. Kjo lidhje siguron që kërkimi artistik të jetë i orientuar drejt praktikës, risive dhe përmirësimit të vazhdueshëm. UART synon të nxisë zhvillimin e projekteve kërkimore artistike dhe krijuese që kontribuojnë në skenën kulturore të vendit, rritjen e cilësisë së prodhimit artistik e për rrjedhojë edhe përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies. Nëpërmjet bashkëpunimeve ndërdisiplinore, aty ku është e mundshme, pjesëmarrjes në evente artistike të të gjitha formave të zotëruara nga stafet tona akademike, si dhe publikimeve, UART synon të jetë një qendër referimi për inovacionin artistik dhe shkencor në nivel lokal, kombëtar e më gjerë.

### Përmbledhje e veprimtarisë kërkimore, krijuese dhe inovative (2024–2025)

Gjatë vitit akademik 2024–2025, Fakulteti i Muzikës; Fakulteti i Artit Skenik dhe Fakulteti i Arteve të Bukura, kanë zhvilluar një aktivitet të gjerë kërkimor, krijues dhe inovativ, duke integruar mësimdhënien, veprimtarinë artistike dhe kërkimin shkencor. Veprimtaria ka përfshirë artikuj shkencorë, kumtesa në konferenca ndërkombëtare, pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe botime dhe promovime artistike të stafit akademik dhe studentëve.

### Veprimtaria kërkimore dhe akademike:

- **Artikuj shkencorë:** Stafi akademik ka publikuar artikuj shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, duke trajtuar tematika të fushës së muzikës; artit skenik dhe arteve figurative (psh muzikës tradicionale dhe bashkëkohore shqiptare, interpretimit, muzikologjisë dhe historisë së artit muzikor, etj)
- **Kumtesa dhe konferenca:** Një numër i konsiderueshëm kumtesash dhe prezantime janë mbajtur nga stafi dhe studentët në konferenca ndërkombëtare të njohura si ICAE, READ dhe IRMC, duke forcuar ndërveprimin me komunitetin shkencor dhe artistik ndërkombëtar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- **Projekte dhe aktivitete artistike:** Fakultetet kanë organizuar dhe mbështetur projekte artistike të rëndësishme, duke përfshirë konkurse, koncerte, recitale, masterklas ndërkombëtare dhe aktivitete promovuese si “Open Day” dhe festivale të studentëve.

Gjatë vitit akademik 2024–2025, UART ka zhvilluar një veprimtari intensive kërkimore, artistike dhe organizative, e shtrirë në të nëntë departamentet e Fakulteteve. Në mënyrë të veçantë, dëshirojmë të evidentojmë organizimin e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare “Arts and Education”, e cila është njëherazi edhe konferenca e parë shkencore e këtyre përmasave në Republikën e Shqipërisë, organizuar nga Universiteti i Arteve. Në konferencë morrën pjesë mbi 100 artistë dhe kërkues shkencor nga Shqipëria, vendet e rajoni dhe më gjerë. Gjithashtu, në funksion të mbështetjes së veprimtarive të kërkimit shkencor dhe atij artistik, Universiteti Arteve ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh, sikurse dhe ka inkurajuar stafin e tij akademik të aplikojë, me mbështetjen e administratës dhe organeve drejtuese në UART, në projekte kërkimore. Si rezultat i kësaj politike inkurajuese dhe mbështetëse, Universiteti i Arteve ka fituar projekte në kuadër të thirrjes së Programeve Kombëtare të Kërkimit Shkencor, qoftë në kategorinë e Projekteve të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor e qoftë në atë të Projekteve të Kërkimit Shkencor për vitin 2025, financuar nga AKKSH-i. Njëherazi dëshirojmë të theksojmë se, përpos financimit të siguruar nga fondet publike, për vitin akademik 2024-2025, Universiteti Arteve ka mbështetur kërkimin shkencor edhe falë marrëveshjeve të nënshkruara me Fondin Shqiptaro Amerikan të Zhvillimit (AADF), në kuadër të të cilave janë mbështetur kandidatët për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, nëpërmjet programit READ dhe është mundësuar aksesimi në një ndër libraritë më të rëndësishme ndërkombëtare online si JSTORE.

Fakulteti i Muzikës, gjatë vitit 2024–2025, ka organizuar stinën koncertore e cila përfshiu mbi 70 koncerte, masterclass-e dhe projekte artistike, me pjesëmarrjen e artistëve dhe pedagogëve nga Italia, Spanja, Izraeli, SHBA, Austria, Kosova dhe vende të tjera europiane. Departamentet kanë organizuar masterclass-e, tryeza shkencore, promovime botimesh dhe projekte inovative ndërdisiplinare, duke integruar teknologjinë, muzikën bashkëkohore dhe format e reja të interpretimit.

Më poshtë po japim në mënyrë të detajuar Masterklas; Projekte dhe Aktivitetet Artistike për vitin 2024-2025 të Fakultetit të Muzikës në UART

**Tabela: Masterklas, Projekte dhe Aktivitetet Artistike 2024–2025**

Nr	Lloji i Aktivitetit	Përshkrimi / Detajet	Departamenti / Njësia	Bashkëpunime / Partnerë	Afati	Komente
1	Masterclass	Pianist Bertolazzi (Itali)	Departamenti i Interpretimit	TKOBP	2024-2025	Trajnim profesional për studentët e pianos
2	Masterclass	Violinistët Simone Gramaglia dhe Federika Franchini (Itali)	Departamenti i Interpretimit	OSFA	2024-2025	Trajnim për violinistët e departamentit
3	Masterclass	Pianist Martin Acevedo (Spanjë)	Departamenti i Interpretimit	—	2024-2025	Trajnim ndërkombëtar
4	Masterclass	Pianist Jazz Guy Mintus (Izrael)	Departamenti i Interpretimit	—	2024-2025	Trajnim në jazz dhe improvizim



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr	Lloji i Aktivitetit	Përshkrimi / Detajet	Departamenti / Njësia	Bashkëpunime / Partnerë	Afati	Komente
5	Masterclass	Oboe Andre Jayne Ridilla (USA, Universiteti i Miami)	Departamenti i Interpretimit	–	2024-2025	Trajnim instrumentist i avancuar
6	Masterclass	Pianiste Lejla Pula (Kosovë)	Departamenti i Interpretimit	–	2024-2025	Për studentët e pianos
7	Masterclass	Pianiste dhe muzikologe Silvia Belfiore (Itali)	Departamenti i Interpretimit	–	2024-2025	Analizë dhe interpretim muzikor
8	Masterclass	Jonia Ilia Kadesha dhe artistë të tjerë nga Europa	Departamenti i Interpretimit	Festival Ndërkombëtar Cosmos	2024-2025	Performanca dhe interaktivitet artistik
9	Masterclass	Pianiste Sina Kloke	Departamenti i Interpretimit	Ambasada Gjermane / Tetori Gjerman	2024-2025	Fokus në interpretim profesional
10	Masterclass	Kitarist Luciano Pompillio (Itali)	Departamenti i Interpretimit	–	2024-2025	Trajnim instrumentist
11	Masterclass	Trombonist Alois Eberl (Austria)	Departamenti i Interpretimit	Ambasada e Austrisë	2024-2025	Trajnim frymor profesional
12	Masterclass	Trompist Paolo Paravania (Itali)	Departamenti i Interpretimit	Programi Erasmus+	2024-2025	Trajnim instrumentist
13	Masterclass	Timpanist Florian Klinger (Austria)	Departamenti i Interpretimit	Ambasada e Austrisë	2024-2025	Trajnim instrumentist
14	Masterclass	Kompozitor Salvatore Frega (Itali)	Departamenti KMDP	TKOBP	2024-2025	Masterclass për kompozitorët e rinj
15	Masterclass	Dirigjent ... (detajet të plotësohen)	Departamenti KMDP	–	2024-2025	Trajnim drejtimi orkestre
16	Promovim	Botimi shkencor “Historia e Artit të Tingullit në Botën Shqiptare”	Departamenti KMDP	Akademia e Shkencave	2024-2025	Publikim dhe promovim akademik
17	Tryezë	“Muzikologë dhe Kompozitorë Shqiptarë”	Departamenti KMDP	Open Day	2024-2025	Diskutime dhe shkëmbim eksperiencash
18	Tryezë	Rrumbullake e kompozitorëve të rinj	Departamenti KMDP	–	2024-2025	Mbështetje e talentëve të rinj
19	Stina koncertore	Koncerte me vepra të kompozitorëve të rinj (2 edicione)	Departamenti KMDP	–	2024-2025	Performanca e studentëve dhe stafit

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr	Lloji i Aktivitetit	Përshkrimi / Detajet	Departamenti / Njësia	Bashkëpunime / Partnerë	Afati	Komente
20	Masterclass	Mezosoprano Marta Ęryk	Departamenti Kanto	Ambasada Gjermane	2024-2025	Trajnim vokal profesional
21	Projekt	“Ura me tre harqe”, edicioni 15	Të gjitha departamentet	Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut	2024-2025	Koncerte, film, teater, ekspozite, leksione/seminar
22	Projekt	“Mozart”	Departamenti Interpretimi / TKOBP	—	2024-2025	2 koncerte studentore me orkestrën TKOBP
23	Projekt	“Lost in Translation” / KrijoFest	Të gjitha departamentet	—	2024-2025	Dy mbrëmje artistike interdisciplinare, kombinim muzike dhe vizualiteti
24	Projekt	“Profil” – Endri Sina	Departamenti KMDP	—	2024-2025	Projekt artistik i kompozitorit
25	Projekt	“Profil” – Hajg Zaharian	Departamenti KMDP	—	2024-2025	Projekt artistik i

Aktiviteti kërkimor dhe artistik në UART për vitin akademik 2024–2025 ka theksuar lidhjen e ngushtë mes praktikës artistike dhe kërkimit shkencor. Ky vit ka kontribuar në forcimin e profilit akademik të departamenteve, duke ndihmuar në zhvillimin profesional të stafit dhe studentëve.

**Tabela nr. 2: Për realizimin e qëllimeve dhe objektivave në fushën e kërkimit artistik, shkencor dhe inovacionit.**

Objektivi I: Në funksion të arritjes së qëllimit për fushën e kërkimit shkencor dhe veprimtarive krijuese dhe inovacionit						
Nr	Plani dhe proceset e planifikuara	Aktivitete dhe detyrat konkrete	Fakulteti/Drejtoria/Spektori përgjegjës	Realizimi sipas planit strategjik	Afati	Komente
1	Zhvillimi dhe publikimi i artikujve shkencorë	Publikimi i artikujve të stafit akademik në revista kombëtare dhe ndërkombëtare (7 artikuj në 2024–2025)	Fakulteti Muzikës dhe Departamentet e Interpretimit, KMDP, Kanto	Realizuar sipas planit	Qershor 2025	Artikujt trajtuan muzikën shqiptare, interpretimin dhe muzikologjinë
2	Pjesëmarrja në konferenca dhe kumtesa shkencore ndërkombëtare	ICAE 2025, READ, IRMC, kontributi i stafit dhe studentëve	Departamentet e të gjitha njësive bazë	Realizuar	Tetor – Dhjetor 2025	Mbrojtje e tematikave të interpretimit, muzikës bashkëkohore



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

		me kumtesa të specializuara				dhe historisë muzikore
3	Organizimi dhe pjesëmarrja në projekte artistike dhe ndërkombëtare	Projekte si “Ura me tre harqe”, “Mozart”, “Lost in Translation”, “Profil”	Fakulteti Muzikës dhe Departamentet e Interpretimit, KMDP, Kanto	Realizuar	Maj 2025	Përfshin koncerte, performanca, shfaqje teatrale dhe projekte multimediale
4	Masterklas dhe trajnime ndërkombëtare për studentë dhe staf	Organizimi i 15+ masterklas me pianistë, violinistë, dirigjentë dhe kompozitorë ndërkombëtarë	Fakulteti Muzikës dhe Departamentet e Interpretimit, KMDP, Kanto	Realizuar sipas planit	Maj 2025	Bashkëpunim me ambasadat dhe universitetet partnere
5	Kontributi në botime dhe promovime shkencore dhe artistike	Promovimi i botimeve si “Historia e Artit të Tingullit në Botën Shqiptare”, CD “The Balkan Piano – Volume One”	Fakulteti Muzikës dhe Departamentet e Interpretimit, KMDP, Kanto	Realizuar	Qershor 2025	Përforcon profilin kërkimor dhe krijues të Fakultetit
6	Është planifikuar rritja punës individuale, dhe angazhimi i stafit në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, artistike e shkencore, të cilat synojnë përmirësimin e nivelit të tyre në përgjithësi. Këtë vit një pjesë e stafit u angazhua direkt dhe si prejsëmarrës dhe në Bordin editorial e organizator në konferencën e parë ndërkombëtare të Arteve që u organizua në UART.	Konkretisht pjesë nga Dekanati ishin pjesë kryesore e grupit të punës për organizmit të konferencës ndërkombëtare që u mbajt në muajin qershor në UART. Ky angazhim është në vazhdim e punës shkencore kërkimore e një pjesë të rëndësishme të stafit që mbulon jo vetëm lëndët teorike, por dhe ato speciale-artistike. Aktivitete të tjera të rëndësishme të ngarkuara nga Dekanati dhe Kordinatorët e Programeve të	Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Dekanati ka punuar ngushtësisht me stafin pedagogjik, Shefat e Departamenteve dhe kordinatorët e programeve të studimit, ashtu si dhe me stafin e administratës për angazhimin e stafit pedagogjik dhe në aktivitetet ekstrakurrikulare, të cilat konsistojnë në aktivitete artistike kryesisht, por dhe në fushën e publicistikës, botimeve studimore, katalogeve promovuese artistike, pjesëmarrje në	Sipas planit të çdo vit angazhimi ka qenë maksimal me mbi 80 aktiviteteve artistike të cilat përfishjnë jo vetëm ato artistike, por dhe aktivitete në grup brenda e jashtë vendit, pjesëmarrje në juri kombëtare e ndërkombëtare, si dhe konkurse të shumta gjithashu brenda e jashtë vendit. Gjithashtu një vlerë e veçantë përbëjnë zërat në fushën e publicistikës, botimeve	Të gjithë këto akvite të janë zhvilluar brenda vitit akademik 2024-2025 dhe kanë respektuar të gjithë afatet e vendosur në planin vjetor të punës akademike.	Gjithashtu theksojmë se këto rezultate nuk ndryshojnë shumë nga vitet e mëparshme, çka dëshmon një vijmësi normale në punë tonë të përditshme dhe rezultate të pritshme dhe në vazhdim

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	Përveç kësaj një pjesë e konsiderueshme aktiviteteve artistike, mbi 80 personale dhe në grup janë realizuar nga stafi pedagogjik në të gjithë Fakultetin. Ky numër tejet i lartë aktiviteteve është provë e cilësisë së stafit dhe angazhimit të tyre të përditshëm në skenën e artit bashkohor.	studimit janë dhënë për stafin më të ri pedagogjik për realizimin e aktiviteteve artistike që synojnë promovimin e produktit studentor të paraqitura në tabelën përkatëse.	juri kombëtare e ndërkombëtare, si dhe konkurse të shumta gjithashtu brenda e jashtë vendit.	studimore, katalogjeve promovuese artistike,		
7	Punimi “Aktori Monologist – Teoria dhe Praktika”	(në proces)	FAS	(në proces)	2026	<i>Nuk ka</i>
8	Influence of Italian Television and Cinema in the period of communist dictatorship	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 - 2025	<i>Nuk ka</i>
9	The dreamscape of Ingmar Bergman – Exploring Reality fantasy and the human psyche in cinema	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 - 2025	<i>Nuk ka</i>
10	The Uniqueness of portrayal of the human psyche in Ingmar Bergman Cinema – Inovative cinematic language	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 - 2025	<i>Nuk ka</i>
11	Shfaqja “Vendim Nuremberg”	(në proces)	FAS	(në proces)	2026	<i>Nuk ka</i>



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

12	Mbështetje për provimet e zhvilluara në fakultet sipas pasqyrimeve në regjistër	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
13	Dosja e Filmit: "Ora e ligë"	(në proces)	FAS	(në proces)	2026 2027	ose	<i>Nuk ka</i>
14	Pacienti i Doktor Frojdit – Regjia	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
15	Skenari "30 vite për të vdekur"	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
16	Selektori Festivalit "Dea open Air"	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
17	Skenar Filmi "Të mbaj në krahë"	(në proces)	FAS	(në proces)	2026		<i>Nuk ka</i>
18	Festivali Ballkanik i Filmit Pogradec (ideator - organizator)	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
19	Aktiviteti "Priority Europe" (Bashkimi Evropian mbi ekonomine, ngrohjen globale dhe energjine) – Regjia Televizive	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
20	South Outdoor Festival – Festival Muzikor – Regjia Televizive dhe montazhi	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
21	Samiti Evropian EPC ne Tirane Samit mbi politikat e komunitetit) Regjia Televizive	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
22	"Zi e me zi" – Kristo Floqi – Regjisor	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

23	“Ballkoni i Rektorit” – Antropologji, AADF – Projekti READ	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
24	“Jeta është ëndërr” – pre produksion	(në proces)	FAS	(në proces)	2026 2027	ose	<i>Nuk ka</i>
25	Nga Mesi i Erresires- Dokumentar mbi aktivitetin artistik te regjisorit Kristaq Dhamo	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
26	Juria Ndërkombëtare e festivalit TIFF – anëtar	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
27	Vrasje në Vjeshtë - Roli i Marianit	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
28	Nata e Dymbëdhjetë - Roli i Malvolios	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
29	“Artistët dhe krijuesit e rinj si agjentë ndryshimi në një shoqëri post-tranzicion dhe roli i artistëve të rinj në formësimin e ideve për drejtësi sociale” - referues	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
30	Aktiviteti përkujtimor “Bekim Lumi – Ura që lidhi Kosovën dhe Shqipërinë përmes artit”.	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
31	Konferenca e Parë Ndërkombëtare mbi Artet dhe Edukimin Moderatore e Sesionit në Fakultetin e Artit Skenik	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

32	“Testamenti i ri” – Sacha Guitry – Regjia	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
33	Dokumentari: Xhevahir Spahiu – Narrator, aktore	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
34	Mbremja Poetike “Gruaja e Lire” - aktore	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024 2025	-	<i>Nuk ka</i>
35	Musical: MAMMA MIA, Teatri i Uniersitetit të Arteve,	e përmbushur	FAS	E përmbushur	2024- 2025		<i>Nuk ka</i>
36	Ekspozita personale me temë: NEVERMORE, në Galerinë e Artit UART-Tiranë	e përmbushur	FAS	E përmbushur	2024- 2025		<i>Nuk ka</i>
37	PACIENTI I DR. FROJD, Teatri Bylis, Fier	e përmbushur	FAS	E përmbushur	2024- 2025		<i>Nuk ka</i>
38	ËOMAN BIENALE, Ekspozitë Pikturë, Londër BEATIFUL MIND, eKSPOZITË Pikturë,, Venecia SAPORE DI MARE, Musical, ATELIE CREATIVO, MILANO&ROMA	e përmbushur	FAS	E përmbushur	2024- 2025		<i>Nuk ka</i>
39	VEJUSHA GAZMORE, Musical, Teatri i UART Musical: SOFRA	e përmbushur	FAS	E përmbushur	2024- 2025		<i>Nuk ka</i>



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

40	Musical: MAMMA MIA, Teatri i Uniersitetit të Arteve Spektakel; KRISHTLINDJE NE TIRANE, bashkepunim me TKOB Spektakel; NETET E KLIPIT SHQIPTAR, bashkepunim me RTSH,	e permbushur	FAS	E përmbushur	2024-2025	<i>Nuk ka</i>
41	Ëorkshop në BASHKPUNIM ME AMBASADEN POLAKE, Projekt artistik: TAKONJE KOREOGRAF, bashkepunim me Bashkine Tirane, Spektakel artistik: FESTA E VERES, bashkepunim me Bashkine Tirane, Ëorkshop dhe shfaqje me XCEL INTERNATIONAL DANCE, ATLANTA-USA, Projekt artistik: DANCE, MUSIC, FEST, bashkepunim me Bashkine Vlore	e permbushur	FAS	E përmbushur	2024-2025	<i>Nuk ka</i>



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

42	Projekt artistik: PERFSHIRJA TE RINJVE NE TRASHEGIMINE KULTURORE, bashkepunim me Bashkine Tirane,  Spektakel artistk: ALBANIA EVENT PRODUCTION bashkepunim me Elite Dance Festival Tirane,  Musical: MAMMA	e permbushur	FAS	E permbushur	2024- 2025	<i>Nuk ka</i>
43	Spektakel; PORTOKALLI, bashkepunim me TOP CHANEL, Spektakel; DANCING ËITH THE STARS, bashkepunim me TOP CHANEL,  Spektakel;	e permbushur	FAS	E permbushur	2024- 2025	<i>Nuk ka</i>
44	Veper Teatore, EMIRA – Koreograf, me trupen TK Prishtinë & TK Tiranë, Veper Teatore, DHELPRAT E VOGLA –Teatri Metropolit, Tiranë, Veper Teatore, ANNE BOLEYN – State Theatre, Ankara Turqi,	e permbushur	FAS	E permbushur	2024- 2025	<i>Nuk ka</i>
45	Në detë është parajsa dhe Lucid film aktor  Cifti i çuditëshëm Teatër aktor  Gjaku i martirëve të kombit teatër aktor	E permbushur	FAS	E permbushur	2024- 2025	



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

46	<p>“I Huaj”, Film me metrazh të shkurtër (aktore). Djemtë e lirë film me metrazh të shkurtër. (aktore)</p> <p>Një divorcë një martesë një funeral (regjizore)</p> <p>Këtu vallzon me hijen (aktore)</p>	E përmbushur	FAS	E përmbushur	2024-2025	
47	<p>“Burra të zëmëruar” Aktor - Teatri kombëtar</p> <p>“Aldo de Benedietis” Aktor - Teatri Skampa Elbasan</p> <p>“Pasaporta” - Film artistik - Aktor</p> <p>“Oda pas tempujve që nuk u harruan” Aktor - Film artistik</p>	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	
48	<p>“Hap pas hapi” - Komedi - Regjizore</p> <p>Amfiteatri te liqeni. Tiranë</p> <p>Pjesmarrëse në konferencën e UART Arti dhe edukimi</p> <p>Aktrimi nga teoria në praktikë.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i metodologjive në shkollën e aktrimit shqiptar</p>	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

49	Interpretime poezie në emisionet e T.V Klan e Top Channel Aktor në serial	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	
50	Nëna:aktore T.Eksperimental,  Zhurma jashtë skene (aktore)T.Skampa Elbasan  Mefiskon Faust.T.Kombëtar  Ndodhia e çuditëshme e qenit  Aktore,teatri Metropol  Aktore në filmin  Njëri si ne		FAS	E përmbushur	20242025	
51	1-Regjizore e spektaklit televizivNetët e klipit shqiptar  Pjesmarrëse në Konferencën e UART  Artet dhe edukimi  Regjia dhe regjizori në skenën shqiptare përmes veprimtarisë së regjizorit PANDI STILLU	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	



## REPUBLIKA E SHQIPËRIË

52	Pjesemarrje ne konferencën e UART  Vepra stilistike e piktorit Abdurrahim Buza  Pjesmarrës në ekspozita të përbashkëta UART	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	
53	1Pjesmarrëse e konferencës në UART Artet dhe Edukimi me dy artikuj  Elementi dramatic në eposin e kreshnikëve  Dramaturgjia shqiptare gjat periudhës së realizmit socialist	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	
54	1Pjesmarrëse në konferenca  Rasti I ujit të bekuar.Insiteti albanologjik Prishtin  Riti dhe ritualizimi si proces mes rurales dhe urbanes  Insiteti albanologjik Prishtinë.	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	
55	E kuqe regjizor teatri Eksperimental	E përmbushur	FAS	E përmbushur	20242025	

**b) Informacion mbi bashkëpunime ndërinstucionale dhe projekte ku merr pjesë IAL-ja, të dhëna mbi institucionin bashkëpunues apo projektin; mbi kontratën, datën dhe zyrtarizimit të bashkëpunimit apo të projektit, fusha e bashkëpunimit; detyrat e palëve dhe produktet, rezultatet apo përfitimet që priten nga ky bashkëpunim.**



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjatë vitit akademik 2024-2025, me përjashtim të Marrëveshjes së nënshkruar për Shkëmbim përvoja në mësimdhënie në kuadër të mbështetjes së programit PNRR me Akademinë e Arteve të Bukura të Leces, si dhe punës përgatitore për marrëveshjet me Shkollën e Imazhit dhe Tingullit La Coruna Spanjë (Erasmus KA 171) dhe me Akademinë e Arteve të Bukura të Catanzaro-s (PNRR), Universiteti i Arteve ka vijuar me Marrëveshjet e tjera Ndërinstitucionale të mbështetura nga Programi Erasmus+, KA 171, edhe me institucione të tjera të Arsimit të Lartë Artistik si, Universiteti i Studimeve Tor Vergata Roma Itali, Universiteti “Aldo Moro” Bari, Itali, Shkolla Superiore e Arteve dhe Dizajnit “Mestre Mateo” Santiago Compostela, Spanjë, Universiteti i Arteve të Bukura Budapest, Hungari, Akademia Kombëtare e Arteve të Bukura, Oslo, Norvegji, Akademia e Arteve Bukura Paris, Francë si dhe Universiteti “Aldo Moro” Bari Tiranë / Universiteti i Malit të Zi / Puglia Culture, Bari, Itali. Njëherazi, Universiteti i Arteve, ka vazhduar bashkëpunimin edhe me institucionet e kulturës në Republikën e Shqipërisë.

Falë këtyre bashkëpunimeve është siguruar:

- Përmirësimi i cilësisë së performancës së studentëve dhe stafit.
- Rritja e profilit ndërkombëtar të Fakulteteve të UART
- Zhvillim i vazhdueshëm profesional i stafit dhe studentëve.
- Konsolidimi i tri Fakulteteve si qendër referimi kombëtare dhe ndërkombëtare për muzikën dhe edukimin muzikor.

### **Tabela nr. 3: Mbi bashkëpunimin ndërinstitucional**



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr	Institucioni bashkëpunues	Lloji i bashkëpunimit (projekt/ bashkëpunim tjetër)	Forma e zyrtarizimit të bashkëpunimit apo projektit (marrëveshje ose të tjera)	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Fusha e bashkëpunimit	Detyrat e palëve dhe produktet (të përmbledhura)	Rezultatet/ përfitimet (në vlerë)
1	Universiteti i Studimeve Tor Vergata Roma Itali	Doktorata të dyfishta	Marrëveshje	Hyrë në fuqi viti akademik 2022-2023  (në vijim)	PHD Muzikologji, Art Skenik	2 studentë doktorantë	N.A.
2	Universiteti "Aldo Moro" Bari	Memorandum Mirëkuptim mbi bashkëpunimin në disiplinat Audiovizuale, në Muzikë dhe Spektakël, DAMS mbi Diplomat e Përbashkëta – të FM, FAS dhe FAB të UART	Memorandum Mirëkuptimi	Hyrë në fuqi viti akademik 2022-2023  (në vijim)	DAMS Disiplina Audiovizuale, në Muzikë dhe Spektakël, mbi Diplomat e Përbashkëta – të FM, FAS dhe FAB	N.A.	N.A.
3	Universiteti "Aldo Moro" Bari	Marrëveshje për Bashkëpunim Akademik	Marrëveshje	Hyrë në fuqi 7 Mars 2024	DAMS Disiplina Audiovizuale, në Muzikë dhe Spektakël, mbi Diplomat e Përbashkëta – të FM, FAS dhe FAB	N.A.	N.A.
4	Universiteti "Aldo Moro" Bari	Marrëveshje për Mobilitetin e studentëve	Marrëveshje	Hyrë në fuqi 7 Mars 2024	DAMS Disiplina Audiovizuale, në Muzikë dhe Spektakël, mbi Diplomat e Përbashkëta – të FM,	N.A.	N.A.

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

					FAS dhe FAB		
5	Universiteti "Aldo Moro" Bari/ Universiteti i Malit të Zi/ Puglia Culture	Marrëveshje katër palëshe	Marrëveshje	Hyrë në fuqi Korrik 2025	Disiplina Audio-vizuale, në Muzikë dhe Spektakël,	N.A	N.A.
6	Shkolla Superiore e Arteve dhe Dizajnit "Mestre Mateo" Santiago Compostela	Marrëveshje ndërinstitucional e Mobiliteti Erasmus	Marrëveshje ndërinstitucional e	Hyrë në fuqi viti akademik 2024-2025 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	Erasmus KA 171
7	Shkolla e Imazhit dhe Tingullit – La Korunja, Spanjë	Marrëveshje ndërinstitucional e Mobiliteti Erasmus	Marrëveshje ndërinstitucional e	Hyrë në fuqi viti akademik 2025-2026 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	Erasmus KA 171
8	Universiteti i Arteve të Bukura Budapest	Marrëveshje ndërinstitucional e Mobiliteti Erasmus	Marrëveshje ndërinstitucional e	Hyrë në fuqi viti akademik 2024-2025 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	Erasmus KA 171
9	Akademia Kombëtare e Arteve të Bukura Oslo	Marrëveshje ndërinstitucional e Mobiliteti Erasmus	Marrëveshje ndërinstitucional e	Hyrë në fuqi viti akademik 2024-2025 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	Erasmus KA 171
10	Akademia e Arteve të Bukura Catanzaro	Marrëveshje mirëkuptimi	Marrëveshje	Hyrë në fuqi viti akademik 2025-2026 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	PNRR
11	Akademia e Arteve të Bukura Paris	Marrëveshje ndërinstitucional e Mobiliteti Erasmus	Marrëveshje ndërinstitucional e	Hyrë në fuqi viti akademik 2025-2026	Arte të Bukura	Shkëmbim përvoje në mësimdhënie	Erasmus KA 171



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

				(në vijim)			
12	Akademia e Arteve të Bukura Lecce	Marrëveshje mirëkuptimi	Marrëveshje	Hyrë në fuqi viti akademik 2023-2024 (në vijim)	Arte të Bukura	Shkëmbim përvojë në mësimdhënie	PNRR
13	TKOB	Koncerte me studentët solistë; projekt artistik	Marrëveshje bashkëpunimi	Prill 2025	Muzikë interpretative, edukim artistik	Staf dhe studentë pjesëmarrës në 4 koncerte, organizim programi dhe repertori	Rritja e aftësive performative të studentëve, profil ndërkombëtar i Fakultetit
14	Orkestra Simfonike RTSH	Koncerte dhe projekte artistike.	Marrëveshje bashkëpunimi	2024	Muzikë interpretative	Pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve në koncerte dhe rezidenca	Përvojë profesionale dhe artistike për studentët, konsolidim i marrëdhënies institucionale
15	OSFA	Koncerte dhe rezidenca artistike	Marrëveshje bashkëpunimi	2024	Muzikë interpretative	Pjesëmarrja në koncerte dhe masterklase si dhe bashkëpunime	Rritja e aftësive performative, promovim i talentëve të rinj
16	Liceu Artistik "Jordan Misja"	Masterklase, edukim i përbashkët pedagogjik	Marrëveshje bashkëpunimi	2024	Edukim, zhvillim profesional	Organizim masterklasash, mentorim i studentëve	Përmirësimi i aftësive teknike dhe interpretative të studentëve, bashkëpunim i qëndrueshëm akademik
17	Instituti Italian i Kulturës	Masterklase dhe aktivitete ndërkombëtare	Marrëveshje bashkëpunimi	2024	Muzikë, edukim artistik	Realizimi i masterklasave, performanca studentësh	Rritja e njohjes ndërkombëtare, bashkëpunime të reja artistike
18	Ambasadat Gjermane, Austriake, Çeke	Masterklase dhe aktivitete kulturore	Marrëveshje bashkëpunimi	2024-2025	Muzikë, edukim, kulturë	Organizim dhe zhvillim aktiviteteve, mbështetje materiale	Intensifikim i marrëdhënies diplomatike dhe kulturore, profil



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

							ndërkombëtar i Fakultetit
19	Fondi Amerikan për Zhvillim READ	Projekte kërkimore dhe artistike	Marrëveshje bashkëpunimi	2024	Kërkim shkencor, muzikë	Pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në projekte, analiza dhe publikime	Eksperiencë kërkimore e avancuar, publikime dhe promovim i talenteve
20	Festivalet Ndërkombëtare (Kosmos, Flauti Magjik, KrijoFest, Brass Fest, Fest Jazz, Pianodrom, Gjon Mili Jazz)	Koncerte, masterklase dhe performanca multidisiplinare	Marrëveshje bashkëpunimi	2024-2025	Muzikë, edukim, performanca artistike	Pjesëmarrja në koncerte, masterklase, kurime artistike dhe koordinim programi	Rritja e profilit artistik ndërkombëtar, prezantimi i studentëve dhe stafit në festivale prestigjioze
21	Teatri Kombëtar	Bashkëpunim	Marrëveshje	2025	Regji - Aktrim	*	
22	Teatri Kombëtar Eksperimental Kujtim Spahivogli	Bashkëpunim	Marrëveshje	2023	Regji Aktrim	**	
23	Teatri i Metropolit	Bashkëpunim	Marrëveshje	2023	Regji Aktrim	***	
24	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	Bashkëpunim	Marrëveshje	2023	Regji Filmi	****	

- \* - Jemi angazhuar dhe për tju përgjigjur thirrjeve dhe njoftimeve të TK, duke përcjellë të gjitha informacionet te studentët e FAS. FAS do të përzgjedhë për çdo vit akademik dy shfaqje të mira për mbrojtje diplome. TK do të ofrojë stazhe dhe praktika për studentët në Festivalin e shkollave të mesme TR- RIN ART. Të afrojnë stazhe dhe praktika për studentët në shfaqjet e ardhëshme duke qenë produksione të TK, si regjisor, kostumograf, scenograf, si asistencë. Dhënies së ambjenteve sipas mundësive, të rekuizitës, dekorit dhe kostumeve për qëllime akademike dhe për shfaqje diplome. Të garantojnë pjesëmarrjen e studentëve në Forumet e Debatit, për shfaqje që janë produksione të TK, dhe ëorkshope me personalitete ndërkombëtare në fushën e Arteve Skenike. Etj.

- \*\* - FAS, do të përzgjedhë për çdo vit akademik shfaqje për mbrojtje diplome, të cilat do të jepen në sallën e TKEKS.. TKEKS, ka detyrime të shkëmbimeve të njohurive, stafit dhe infrastrukturës. Shkëmbime përvojë sipas rastit, shkëmbime materialeve studimore, botime, shkëmbim të stafit dhe eksperteve. Për zhvillimin e shfaqjeve, leksioneve, trajnimeve. Pjesëmarrës në produksionet teatrore të TKEKS, aktivitete prezantuese dhe promovuese, bashkëbisedime me studentët, dhënies së lejes për përdorimin hapësirave për përdorimin e ambienteve, për ëorkshope, rekuizitës, kostumeve, dekorit etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- \*\*\* - FAS, do të përzgjedhë për çdo vit akademik shfaqje për mbrojtje diplome, të cilat do të jepen në sallën e TM.. TM, ka detyrime të shkëmbimve të njohurive, stafit dhe infrastrukturës. Shkëmbime përvoje sipas rastit, shkëmbime materialeve studimore, studentët, dhënies së lejes për përdorimin hapësirave për përdorimin e ambienteve, për ëorkshope, rekuizitës, kostumeve, dekorit etj.

- \*\*\*\* - Realizimin e filmave diplome të vitit të tretë të studentëve të programit të studimit Bachelor në Regji Filmi & Televizioni me anë të financimeve nga QKK. Shfaqja e përbashkët e fimave të prodhuar nga ky bashkëpunim dhe mundësia e promovimit të studentëve tanë dhe të prodhimeve të realizuara prej tyre në festivale dhe në evente të tjera filmike rajonale dhe ndërkombëtare. Fondet e lëvruara nga QKK do të menaxhohen nga shtëpi prodhimi filmike vendase, një pjesë e mirë e të cilave janë ngritur nga ish alumni të FAS.

**c. Informacion mbi kërkimin shkencor në IAL ose mbi projekte ku merr pjesë si palë aktive, i cili përfshin:**

**i. Politikat e kërkimit shkencor.**

Gjatë vitit akademik 2024-2025, lidhur me tabelën 4, Universiteti i Arteve, në parteritet me aktorë të rëndësishëm të skenës së rrjeteve ndërkombëtare, ku artet në një kuptim të gjerë bëjnë pjesë, mori pjesë në fazën e aplikimeve për thirrjet e programeve Creative Europe Maj 2025 si dhe Interreg IPA South Adriatic Shtator 2024. Nga 6 projekt propozime të paraqitura, Universiteti i Arteve është shpallur fitues dhe i financueshëm në programin Creative Europe me projektin “Melodious Shade”.

**Tabela nr. 4: Mbi Projekte e kërkimit shkencor/artistik në të cilat IAL ka aplikuar për financim.**

Projekte të aplikuara për financim				
Nr	Emër Mbiemër (Koordinator)	Fakulteti	Titulli i Projektit	Institucioni Financues / Bashkëpunues
1	Miltiadh Kutali	FAS	Melodious Shade	Creative Europe
2	Pjetër Guralumi	Rektorati	MRfP	Creative Europe
3	Pjetër Guralumi	Rektorati	SOB EUROPE	Creative Europe
4	Pjetër Guralumi	Rektorati	Vision	Interreg IPA South Adriatic
5	Pjetër Guralumi	Rektorati	UniValens+	Interreg IPA South Adriatic
6	Pjetër Guralumi	Rektorati	FuturArt	Interreg IPA South Adriatic
7	Elis Mataj	FAS	Për Rritjen e Prodhimit Filmik në Fakultetin e Arteve Skenike, Universiteti i Arteve, Tiranë.	PIKSH
8	Alert Çeloaliaj	FAS	Atelieri i Hapur i Filmit për Krijimtarinë dhe Trashëgiminë	PIKSH
9	Prof. Asc. Dr. Ermir Hoxha	FAB	Shtim Pajisjesh dhe modernizim i laboratorëve në FAB (Laboratori Tekstil & Modë)	Finacues AKKSHI - Agjensia Kombëtare e Kërkimit shkencor dhe Inovacionit
10	Prof. Vladimir Myrtezaj	FAB	Inovacion për kërkimin shkencor në Artin Pamor	Finacues AKKSHI - Agjensia Kombëtare e Kërkimit shkencor dhe Inovacionit

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

11	Prof. Sadik Spahija	FAB	Shtim paisjesh dhe modernizimi i Laboratorëve në FAB (Laboratori i Qeramikës dhe i Skulpturës	AKKSHI
----	---------------------	-----	---	--------

**ii. Të dhëna mbi lidhjen e kërkimit shkencor mbi mësimdhënien.**

**Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien (2024–2025)**

Gjatë vitit akademik 2024–2025, stafi akademik i UART ka qenë aktivisht i përfshirë në punë kërkimore, duke përfshirë studime doktorale, projekte muzikologjike, kompozicion, performancë, ekspozita personale dhe ekspozita në grup. Pedagogët kanë mbajtur rreth 20 kumtesa në konferencën ICAE 2025 dhe në evente të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe kanë botuar artikuj shkencorë brenda dhe jashtë vendit, duke kontribuar në njohjen dhe promovimin e artit shqiptar.

Kërkimi shkencor është i integruar ngushtë me procesin e mësimdhënies. Studentët marrin pjesë aktivisht në projekte, në praktikë artistike dhe studime laboratorike, duke zhvilluar aftësi analitike, kreative dhe profesionale. Kjo përfshirje forcon motivimin dhe përgatitjen për karrierën artistike.

Rezultatet e kërkimit ndikojnë drejtpërdrejt në përditësimin dhe modernizimin e programeve të studimit dhe kurrikulave mësimore. Metodatat e reja, teknologjitë digjitale dhe studimet krahasuese ndërkombëtare integrohen në procesin mësimor, duke siguruar që studentët të zhvillojnë aftësi bashkëkohore, të harmonizuara me standardet artistike dhe kërkimore globale. Kjo krijon një cikël të qëndrueshëm për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës akademike dhe artistike.

**iii. Produktet në fushën e kërkimit shkencor të paraqitura në formën e botimeve shkencore, artikujve, projekteve të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrjes në veprimtari brenda dhe jashtë vendit, veprimtari shkencore të organizuara nga njësi bazë, bashkëpunime me institucione të tjera në nivel vendor, kombëtar apo ndërkombëtar të shoqëruara me të dhëna mbi datën, vendin dhe pjesëmarrësit;**

**Produktet në fushën e kërkimit shkencor (2024–2025)**

Gjatë vitit akademik 2024–2025, në Universitetin e Arteve është zhvilluar një aktivitet i gjerë kërkimor artistiko - shkencor, i cili ka integruar ngushtë mësimdhënien, performancën artistike dhe bashkëpunimet ndërkombëtare. Në qendër të këtij aktiviteti ka qenë Konferenca Ndërkombëtare ICAE 2025, e organizuar nga Fakulteti i Muzikës në bashkëpunim me institucione simotra në Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi dhe Itali, ku pedagogët dhe studentët kanë paraqitur rreth 20 kumtesa mbi muzikën shqiptare, duke kontribuar në promovimin e saj jashtë vendit.

Është organizuar një konferencë mbarëkombëtare në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave, ku janë trajtuar sfidat dhe perspektivat e muzikës shqiptare, duke nxitur diskutime akademike dhe shkëmbim përvojash midis studiuesve vendorë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Përveç konferencave, stafi pedagogjik ka publikuar artikuj shkencorë në revista kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasuruar literaturën mbi artin shqiptar në përgjithësi.

Bashkëpunimet me institucione si: TKOB; Orkestra e RTSH-së; Orkestra e Forcave të Armatosura (OSFA); Ministrisë së Kulturës, Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambli Popullor, Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Teatrit të Kukullave, Teatrit Kombëtar, Teatrit Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”, Teatrit të Metropolit; Galeria Kombëtare e Arteve; Agjencia Kombëtare e Turizmit; Instituti Italian i Kulturës; Akademia e Shkenace e Shqipërisë; etj., organizimi i festivaleve kombëtare dhe ndërkombëtare, kanë lehtësuar integrimin e kërkimit shkencor me performancën artistike, duke rezultuar në masterklase, projekte performuese dhe dokumentim të performancave.

### Produktet e kërkimit shkencor dhe aktivitetet e realizuara

Nr	Produkti / Aktiviteti	Lloji	Vend/Organizim	Niveli bashkëpunues	Data	Pjesëmarrës
1	Konferenca ICAE 2025	Konferencë ndërkombëtare	UART, Tiranë	Ndërkombëtar	Maj 2025	Staf pedagogjik, studentë, mysafirë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Italia
2	Konferencë mbarëkombëtare me Akademinë e Shkencave	Konferencë	Tiranë	Kombëtar	Qershor 2025	Staf pedagogjik, studentë, akademikë vendorë
3	Artikuj shkencorë (7 artikuj të botuar)	Publikim	Revista kombëtare dhe ndërkombëtare	Vendor dhe ndërkombëtar	2024–2025	Staf pedagogjik
4	Projekt kërkimor i integruar me masterklase dhe performanca	Projekt dhe veprimtari artistike	Tiranë / bashkëpunime jashtë vendit	Kombëtar dhe ndërkombëtar	Tetor 2024 – Nëntor 2025	Staf pedagogjik, studentë, artistë të ftuar
5	Pjesëmarrje në konferenca dhe kumtesa jashtë vendit	Konferenca dhe kumtesa	Itali, Mali i Zi	Ndërkombëtar	2024–2025	Staf pedagogjik

Gjithashtu, pedagogët dhe studentët e UART kanë marrë pjesë në konferenca dhe kumtesa jashtë vendit, sidomos në Itali dhe Mal të Zi, duke forcuar rrjetet ndërkombëtare të bashkëpunimit shkencor dhe artistik. Të gjitha këto aktivitete kanë për qëllim jo vetëm avancimin e kërkimit shkencor, por edhe përditësimin e programeve mësimore, modernizimin e kurrikulave dhe zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit.



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Në përgjithësi, viti akademik 2024–2025 shënoi një rritje të ndjeshme të profilit kërkimor artistiko shkencor të UART, duke forcuar rolin e tij si qendër referimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

**Tabela nr.5: Mbi Aktivitetet e kërkimit shkencor të realizuara (2024–2025)**

Nr	Aktiviteti	Fakulteti	Partnerët	Data / Vendi	Vlera	Produkti (Proceeding Book, ISBN/Revistë)
1	Konferenca ICAE 2025 (Ndërkombëtare)	FM	Institucione simotra nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Italia	Maj 2025, UART, Tiranë		Proceeding Book, ISBN, kumtesa nga 20 pedagogë dhe studentë
2	Konferencë mbarëkombëtare me Akademinë e Shkencave	FM	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Qershor 2025, Tiranë		Proceeding Book, kumtesa mbi muzikën shqiptare
3	Botimi i artikujve shkencorë	FM	Revista kombëtare dhe ndërkombëtare	2024–2025		7 artikuj shkencorë, ISBN/ISSN
4	Projekt kërkimor i integruar me masterklase dhe performanca	FM	TKOB, Orkestra RTSH, Orkestra OSFA, festivale ndërkombëtare	Tetor 2024 – Nëntor 2025, Tiranë		Raporte projektsh, dokumentim i performancave, videoregistrime
5	Pjesëmarrje në konferenca dhe kumtesa jashtë vendit	FM	Konservatorë dhe universitete në Itali, Mali i Zi	2024–2025		Kumtesa, dokumentim online, publikime të bashkëpunimit
6	Ekspozita Arkitektura dhe Inxhinjria Emblematike ne Spanjen Bashkohore	FAB	Ambasada Spanjolle	nëntor 2024		
7	Ekspozita, Bashkëbisedim me Mjeshtrat, Ekspozite nga Fondi i GKA, kuruar nga Anisa Skënderi	FAB	Galeria Kombëtare e Arteve	Dhjetor 2024		
8	Edicioni i 4 poster festival Prishtina / kuruar nga Rrezeart Galica	FAB	Fakulteti I Arteve Prishtinë	Dhjetor 2024		
9	Ekspozita personale e piktorit Besim Tula ‘‘Të ndjesh pamjen’’ Tribute	FAB	Mars Design	Janar 2025		

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



## REPUBLIKA E SHQIPËRIË

	Kuruar nga Era Tula					
10	“Tëinkel Tëinkel” 1 / 2 Ekspozite me punime te perzgjedhura nga studentet e FAB	FAB		Shkurt 2025		
11	Ekspozita Prestanome, Helidon Haliti pedagog ekspozitë personale	FAB	Vizart	Mars 2025		
12	Ekspozita Substance in memoriam, Prof. Ali Oseku tribute personale Kuruar nga Najada Hamza	FAB	Studio OSEKU	Prill 2025		
13	Ekspozita e stafit pedagogjik të FAB 1 / 2 Kuruar nga Shpëtim Kërçova	FAB		Maj Qershor 2025		
14	Ekspozita e Fotografise Diell n’ mes t’nates, me foto nga Savina Tuzi dhe Erti Stermasi, kuruar nga Orestia Kapidani, dhe Rozita Habazaj	FAB	Galeria FAB	Qershor 2025		
15	Ekspozite ne Grup kuruar nga Kamuran Goranci, dhe shoqata e artisteve kosovar	FAB	Shoqata e Artistëve të Pavarur kosovar	Shtator 2025		
16	Ekspozita Close as distant horizont, ekspozite e organizuar nga Ambasada Kineze	FAB	Ambasada Kineze	Shtator 2025		
17	FOCUS – Konkurs ndërkombëtar i fotografisë Ëorkshop i Prog. Stud. Fotografi	FAB	FOKUS	Shtator 2025		
18	Ekspozita Atelieri i Grafikes Harri Aleks L. Muça	FAB	Galeria FAB	Shtator 2025		
19	Ekspozite “Starbuster” Kurator : Prof. Najada Hamza.	FAB	Qendra Kulturore per Femije, Durres.	Shtator 2024		
20	Java Kulturore Amerikane ne puntorine e Noor Bchara ne bashkepunim me Atelieren Tekstil dhe Mode, Fakulteti Arteve te Bukura . Kurator: Prof. Najada Hamza, Ardian Kapo dhe Genc Permeti.	FAB	Noor Bchara	Tetor 2024		
21	Ekspedite mesimore ne qytetin e Prizrenit, Kosove.	FAB	DB	Tetor 2024		
22	Ekspozite nga studentet e Atelierit Tekstil dhe Mode ne hapesiren RinArt, Belesh.	FAB	Bashkia Belsh	Tetor 2024		



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

23	“OPEN DAY” ne Fakultetin e Arteve te Bukura, Atelieri Tekstil dhe Mode Atelieri Skulpturë dhe Qeramikë	FAB	UART	Dhjetor 2024		
24	“TR_cufting_school TR”. Ëorkshoop me studentet e Atelierit Tekstil dhe Mode nga mjeshtri Shing Sato.	FAB	Shing Sato.	Shtator 2025		
25	Sfilate ne ART Explora Festival Durres (studenti Francesko Berati).	FAB	Explora Festival Durres	Prill 2025		
26	Eksedite mesimore ne qytetin e Korces. Vizita ne ambjentet e: Muzeu Gjon Mili, Bratko museum, Muzeu mesjetar Kombetar,, Galeria Eri Art.	FAB	UART	Maj 2025		
27	Ëorkshoop nga Prof. Paël Dobrycky me studentet e Atelierit e Tekstil dhe Mode. “ Krijimi I nje kostumi me tre hapa bazuar ne tre pjeset e tragjedise Greke”.	FAB	Prof. Paël Dobrycky	Qershor 2025		
28	Ekspo Art Crafts, Qendra tregtare Teg. Kurator : Prof.Najada Hamza, Ardian Kapo dhe Genc Permeti.	FAB	Qendra tregtare Teg.	Prill 2025		
29	Projekti CROSSING në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis Accademia di Belle Arti di Napoli dhe Universitetit të Arteve	FAB	Akademia e Arteve ne Napoli	Maj 2025		
30	“Ëanderlust in Albania 2” per Agjencinë Kombëtare të Turizmit Ndër 5,000 fotografi dhe 750 video të dërguara nga 36 shtete, juria përzgjedhi nga 3 fitues për secilën nga 11 kategoritë e konkursit.	FAB	Agjencinë Kombëtare të Turizmit	Prill 2024		
31	Ëorkshopi Me rastin e Ditës së <b>Made in Italy</b> , Instituti Italian i Kulturës së Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin e Arteve, organizoi një masterclass interesant me dy protagonistë të skenës kinematografike dhe dixhitale italiane: <b>Pasquale Di Viccaro</b> , supervizor i efekteve vizuale (VFX) në filmin “Il tempo che ci vuole” të Francesca	FAB	Instituti Italian i Kulturës së Tiranës,	Prill 2025		



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	Comencini dhe <b>Enrico Paolantonio</b> , regjisor dhe autor i filmit të animuar “La bicicletta di Bartali”					
32	MuseX (The Balkans’ hub for music, arts, and creative industries, featuring an Expo, Conference, and Festival)	FAB	creative industries	Prill 2025		
33	“Vepra te zgjedhura te studenteve te Fakultetit te Arteve te Bukura ne festivalin e artit bashkekohor RINART”, kuruar nga Helidon Haliti, Galeria ‘‘Dy bote’’, Seferan, Belsh	FAB	Galeria ‘‘Dy bote’’, Seferan, Belsh	Nëntor 2024		
34	Ëorkshop: "Teknikat fotografike per komunikimin arkitektonik"	FAB	Ambasada Spanjolle	Nentor 2025		
35	Masterclass“Teknikat e hershme të fotografisë”, të drejtuar nga Maximilian Zeitler, Jonas Ruhs dhe Elvis Halilovic. Programi u zhvillua në Shkodër dhe përfshiu ndërtimin e kamerave pinhole, punë në dhomë të errët, pllaka të thata, si dhe teknikat cyanotype dhe luminogram.	FAB	Muzeu Marubbi	Tetor 2025		
36	Ekspozitë event “Dyzuar”, në kuadër të The Bulevard Shoë (hapësira Dyqan, Bulevardi i Ri, Tiranë).	FAB	The Bulevard Institute	Shtator 2025		
37	Ëorkshop “Hapësira që zhduken, gjurmë që mbeten”, përqendruar në teknikën cyanotype.	FAB	Muzeu Marubi	Shtator 2025		
38	Ekspozita “HOMEËARD” (në kuadër të 10-vjetorit të Art House), në Muzeun Marubi dhe hapësira të tjera në Shkodër.	FAB	Art House	Shtator 2025		
39	Ëorkshop “Artificial Intelligence vs Human Intelligence”, me studentë të Fotografisë dhe Grafikës, në bashkëpunim me Istituto Italiano di Cultura – Tirana (IIC).	FAB	Istituto Italiano di Cultura	Shtator 2025		
40	Ëorkshop“Ëorldëide Pinhole Day”, në Fotolab UART, nën drejtimin e Prof. Albes Fusha.	FAB	Fotolab UART	Tetor 2025		
41	Masterclass “Eksplorim në botën vizuale të Gregor Creëdson”, me studentë të Fotografisë dhe Grafikës, mbi	FAB	Gregory Creëdson	Mars 2025		



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

	ekspozitën “Eveningside” të artistit.					
42	Ekspozita “Tëinkle Tëinkle III”, Shkodër, mars, 2025	FAB	Galeria e Artit Shkodër			
43	“NO ART ZONE”, nga Vladimir Myrtezai në bashkëpunim me Noel Myrtezai. Kuruar nga Helidon Gjergji.	FAB	COD-Center for Openness and Dialogue Kryeministria			
44	Ekspozita “Maska që zbulojnë”, Spaç, kuruar nga Edison Çeraç	FAB	Spaç, Muzeu i Memories	Tetor, 2025		
45	Workshop, “Life is Art, Live Yours in Colours” —çmim special. Me studentët e programit të studimit Pikturë-Grafikë	FAB	Ambientet e ateliesë së Grafikës.	Nëntor 2024		
46	Workshop 3-Dizajn dhe Koncept” —ditor me studentët e Grafikës (bachelor dhe master) mbi dizajnin grafik dhe kartolinën elektronike,	FAB	Bashkëpunim me AKSHI.	Dhjetor 2024		
47	Workshop “Love, Space and Motion” —animacioni dhe sound, nën drejtimin e pedagogut Harri Aleksi dhe mentorimin e pedagogut Marsel Zara, me studentë të Fakultetit të Arteve të Bukura.	FAB		Mars 2025		
48	Workshop “The Cyanotype & Polaroid Transfer” — Ëorkshop i teknikave dhe demonstrim nga studentët master të Grafikës: Anjeza Mema dhe Franc Hasa.	FAB		Mars 2025		
49	“Twinkle Twinkle” — Ekspozitë me punime të studentëve të Fakultetit të Arteve të Bukura në Fier.	FAB	Galeria e Artit Vilson Kilica Fier	Maj 2025		
50	Ekspozitë dhe Workshop “Art & Crafts. Eksperimente dhe Printime në Sipërfaqe Subtile” — me studentët e Grafikës dhe Tekstilit në ambientet e TEG.	FAB	TEG	Korrik 2025		
51	Monografia ‘Arben Bajo – vepra e plotë’, (Tiranë: Ëest Print 2024) Autor Ermir Hoxha	FAB		Dhjetor 2024		ISBN: 978-9928-363-91-6



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

52	ICAE International Conference ARTS AND EDUCATION, University of Arts, Tirana, Albania, autor i paper mbi ,“Një histori e shkurtër e institucioneve artistike shqiptare“ si dhe pjesë e Komitetit Organizues. <i>Ermir Hoxha</i>	FAB	UART	Qershor 2025		978-9928-4860-5-9
53	International forum, “Landscape Architecture in Albania: Challenges and Potentials”, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, paper ,“ Albanian landscape in the 20th century: a multifaceted ëindoë into local realities.“ <i>Ermir Hoxha</i>	FAB	Akademia e Shkencave e Shqipërisë	Qershor 2025		
54	Forumi “Personalitetet themelues të arsimit të lartë dhe të shkencës në Shqipëri”, organizuar nga “Akademia Shqiptare e Arteve dhe Shkencave”, paper me subjekt “Mbi disa nga personalitetet e arteve figurative - një histori e shkurtër”. <i>Ermir Hoxha</i>	FAB	Akademia e Arteve dhe Shkencave e Shqipërisë			
55	Ekspozitë personale, 21° Festival Internazionale della Fotografia, Orvieto fotografia 2025 Orvieto. Itali (Fotografi)	FAB	° Festival Internazionale della Fotografia, Orvieto	Mars 2025		
56	Ekspozita “VAGULLNAJA VIZUALE 1- 2, Prishtine. Kosove. (Fotografi) Pedagogët e FAB: S. Spahija; E. Krisiko; A. Marku	FAB	Galeria Naim Spahiu	Shtator – Tetor 2025		
57	Ekspozita “NË TË NJËJTËN ORBITË”, Ekspozitë e studentëve të programit fotografi në kuadër të “Fokus AËARD 15”, Galeria FAB, Tiranë. Shqipëri. Kuruar nga Albes Fusha	FAB	FOKUS	Tetor 2025		
58	Ekspozita “in Memoriam” Alqi Gollosi, Leon Çika, kuruar nga Albes Fusha në kuadër të “Fokus AËARD	FAB	FOKUS	Tetor 2025		



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

59	“EYES OPEN ÈHEN IT’S DARK” Albes Fusha, Artist	FAB	Punctum photofestival 4. Maqedonia e Veriut. (fotografi)	Shtator 2025		
60	Ekspozita e stafit pedagogjik të FAB 1/2 Kuruar nga Shpëtim Kërçova	FAB	FAB	Maj 2025		
61	Ekspozitë në grup “Dream Escape” – Një udhëtim mes realitetit dhe nëndërgjegjes, Helidon Haliti	FAB	MAG	Tetor 2025		
62	Ekspozitë ne grup “Vagullnajat vizuale”, Pedagogët e FAB: S. Spahija; E. Krisiko; A. Marku; H. Haliti	FAB	Open Gallery Prishtinë Galeria Naim Spahiu Prishtinë Galeria MALL Prishtinë	Tetor 2025		
63	Ekspozitë ne grup “Vagullnajat Vizuale”, Pedagogët e FAB, Helidon Haliti	FAB	Flori Gallery Prishtinë	Shtator 2025		
64	Ekspozitë ne grup “Vagullnajat Vizuale”, Pedagogët e FAB: S. Spahija; E. Krisiko; A. Marku; H. Haliti	FAB	Hapësirë Alternative, Tiranë	Shtator 2025		
65	“Gjon Mili” International Video Art Festival Prof.Asoc. Edmond Gjipopulli	FAB	Fshati, Dhërmi	Shtator 2024		
66	Ekspozitë në grup “Salloni i Vjeshtës”, Kurator: Dr. Mikel Temo	FAB	Galeria e Arteve Shkodër	Nëntor 2024		
67	Ekspozitë me fondin pikturë- skulpturë-grafikë në Galerinë e Artit Korçë, Kurator: Dr. Mikel Temo	FAB	Galeria e Arteve GM, Korçë	Prill 2024		
68	Ekspozitë në grup Dream Escape – Një udhëtim mes realitetit dhe nëndërgjegjes, Sadik Spahija, Ergys Krisiko, Artan Marku	FAB	MAG	Tetor 2025		
69	Monumenti i Tafil Buzit, vendosur ne Tepelene nga, Vladimir Llakaj	FAB	Shoqata Tafil Buzi	shtator 2025		
70	Ekspozita personale “The shape of Absence”, e skulptorit Artan Marku	FAB	Gur Gur Gallery	Qershor 2025		

Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 www.uart.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

71	Ekspozita, "Constructin Realites", ekspozitë në grup, Artan Marku,	FAB	Promenade Gallery	Nëntor 2024		
72	Ekspozita dhe konkursi ndërkombëtar mes shkollave të Artit Edgardo Manucci e për akordimin e çmimeve.	FAB	Accademia e Arteve Orvieto	Maj 2025		
73	Zberthimi i teknikave të realizimit të veshjeve dhe bizhuterive tradicionale shkodrane.	FAS	Shkencat Sociale dhe Albanologjike		2,484,260 ALL	

Theksojmë se nga Fakulteti i Artit Skenik janë realizuar një numër i konsiderueshëm projektesh artistike përgjatë vitit 2024-2025.

**iv. Të dhëna mbi infrastrukturën në shërbim të kërkimit shkencor**

- Të dhëna në lidhje me pajisjen e sallave / laboratorëve / bibliotekave me mjete teknike të nevojshme për realizimin e kërkimit shkencor.
- Të dhëna mbi infrastrukturën për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave dhe materialeve të kërkimit shkencor

UART së bashku me tri Fakultetet e tij ka zhvilluar dhe përmirësuar infrastrukturën akademike në funksion të kërkimit artistiko - shkencor dhe mësimdhënies, duke krijuar një mjedis optimal për zhvillimin e proceseve edukative, artistike dhe hulumtuese. Laboratorët e praktikës instrumentale dhe sallat për ushtrime performative janë të pajisura me instrumente të mirëmbajtura (piano, instrumente harkore, frymore dhe të rrymës), pajisje audio-profesionale për regjistrim dhe analizë, si dhe softuer të avancuar për kompozim, përpunim dhe analizë muzikore.

Biblioteka e UART është e pajisur me koleksione të plota muzikore, libra akademikë, revista të specializuara dhe materiale digjitale, duke mundësuar kërkime të avancuara në muzikologji, kompozim, interpretim dhe histori të muzikës. Infrastruktura digjitale për menaxhimin dhe mbrojtjen e të dhënave përfshin databaza të sigurta dhe sisteme të organizuara për ruajtjen dhe qasjen e materialeve kërkimore, duke lehtësuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe përdorimin e informacionit shkencor nga pedagogët dhe studentët.

Biblioteka e UART siguron qasje të rregullt dhe të monitoruar për studentët, pedagogët dhe studiuesit e jashtëm, duke mundësuar hulumtime të avancuara në muzikologji, histori të muzikës dhe kompozim.

Laboratorët dhe sallat instrumentale janë të pajisura me instrumente të mirëmbajtura, pajisje për regjistrim dhe përpunim audio, duke mbështetur realizimin e aktiviteteve kërkimore dhe artistike, si dhe projektet bashkëpunuese ndërinstitucionale.

Ofrimi i shërbimeve për të tretët realizohet me procedura të formalizuara, duke përfshirë marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata për përdorim të instrumenteve dhe laboratorëve, për të garantuar qasje të sigurt dhe të organizuar



Tabela nr.6 pika a: Mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.

Të dhëna për laboratorët/sallat në funksion të programeve të studimit

Njësia Kryesore	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë/....)	Mbështet mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)
FM	Biblioteka e Muzikës – koleksione partituras, libra dhe revista shkencore	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	Konsulta dhe akses i jashtëm për studiues dhe artistë të jashtëm
FM	Laboratorët e Praktikës Instrumentale dhe Kompozimit – instrumente, pajisje audio-profesionale, softuer kompozimi	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	Përdorim i jashtëm për ëorkshop dhe projekte artistike të organizuara me institucione kulturore
FAS	2 Studio-Laboratorë Aktrim	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	2 Studio-Laboratorë Regji	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	5 Laboratorë Regji Filmi & TV	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	4 Laboratorë Skenografi-Kostumografi	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	2 Laboratorë Koreografi	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	1 Laborator-Puntori Dekori	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
	1 Laborator-Garderobë-Rekuizitë-Rrobaqepsi	Mësimdhënie dhe Kërkim artistiko - shkencor	
FAB	1.Laboratori i Grafikës	Mësimdhënien	
	2. Laboratori i Multimedias	Mësimdhënien	
	3. Laboratori i Tekstil & Modës	Mësimdhënien	
	4. Laboratori i Qeramikës	Mësimdhënien	
	5. Laboratori i Materialeve të Forta	Mësimdhënien	
	6. Laboratori i Restaurimit	Mësimdhënien	
	7. Laboratori i Fotografisë	Mësimdhënien	
	8. Laboratori Pikturë Mon.	Mësimdhënien	
	9. Konservim/Restaurim	Mësimdhënien/K.Shkencor	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Biblioteka e Universitetit të Arteve ka vijuar gjatë vitit akademik 2024–2025 një punë të shkëlqyer në ruajtjen, pasurimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e artistike kombëtare. Ajo ka luajtur një rol thelbësor në mbështetjen e artistëve, pedagogëve dhe studentëve, duke ofruar akses të gjerë në koleksione të pasura dhe shërbime bashkëkohore të informacionit.

Përmes fondit të saj të gjerë të librave, partiturave, arkivës dixhitale dhe burimeve multimediale, biblioteka ka qenë një qendër e rëndësishme kërkimore dhe krijuese, që mbështet procesin akademik dhe artistik të Universitetit të Arteve.

Tabela nr.6: pika b Mbi Infrastrukturën e kërkimit shkencor.

Njësia Kryesore	Infrastruktura (Biblioteka/Laboratorë/)	Mbështet mësimdhënien apo/dhe Kërkimin Shkencor	Ofrimi i shërbimeve për të tretët (lloji i shërbimit që ofrohet)
Fakulteti i Muzikës	1.Salla multimediale	<b>Arkiva Dixhitale - Universiteti I Arteve <a href="http://arkiv.uart.edu.al/">http://arkiv.uart.edu.al/</a>.</b> Bibliotekat ofronë sisteme për skanimin dhe digitalizimin e materialeve kërkimore për të lehtësuar aksesin dhe shpërndarjen e informacionit. Qasje online dhe shërbime të mbështetjes për kërkuesit.	1.Institucionet e Artit.( për huazim – nderbibliotekar) 2. Studente alumni 3.Studentet nëpër Universitete e Botës që mbajnë temat e doktoratures dhe Masterave mbi artin dhe kulturën shqiptare 4. Artdashës
	2.Salla leximi me fonde te hapura 3.Fondi mbyllur	<b>Katalogu online – Universiteti i Arteve</b> KOHA - Integrate Library System <b>JSTOR</b> is a digital library of academic journals, books, and primary sources- "https://about.jstor.org/educators <b>IMSLP – Petrucci Music Library.</b> Papagese - Free Sheet Music PDF - <a href="http://imslp.org/">http://imslp.org/</a>	
Fakulteti Artit Skenik	1.Salla multimediale	<b>Arkiva Dixhitale - Universiteti I Arteve <a href="http://arkiv.uart.edu.al/">http://arkiv.uart.edu.al/</a>.</b> Bibliotekat ofronë sisteme për skanimin dhe digitalizimin e materialeve kërkimore për të lehtësuar aksesin dhe	1.Institucionet e Artit.( per huazim – nderbibliotekar) 2. Studente alumni 3.Studentet nepër Universitete e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

		shpërndarjen e informacionit. Qasje online dhe shërbime të mbështetjes për kërkuesit.	Botës që mbajnë temat e doktoratures dhe Masterave mbi artin dhe kulturën shqiptare. 4.Artdashes	
	2.Salla leximi me fonde të hapura 3.Fondi mbyllur	<b>Katalogu online – Universiteti i Arteve</b> KOHA - Integrate Library System <b>JSTOR</b> is a digital library of academic journals, books, and primary sources- "https://about.jstor.org/educators <b>IMSLP – Petruçi Music Library.</b> Papagese - Free Sheet Music PDF - <a href="http://imslp.org/">http://imslp.org/</a>		
Fakulteti i Arteve të Bukura	1.Salla multimediale	<b>Arkiva Dixhitale - Universiteti i Arteve</b> <a href="http://arkiv.uart.edu.al/">http://arkiv.uart.edu.al/</a> . Bibliotekat ofronë sisteme për skanimin dhe digitalizimin e materialeve kërkimore për të lehtësuar aksesin dhe shpërndarjen e informacionit. Qasje online dhe shërbime të mbështetjes për kërkuesit.	1.Institucionet e Artit.( për huazim – nderbibliotekar) 2. Studente alumni 3.Studentet nëpër Universitete e Botës që mbajnë temat e doktoratures dhe Masterave mbi artin dhe kulturën shqiptare 4. Artdashës	
	2.Salla leximi me fonde të hapura 3.Fondi mbyllur	<b>Katalogu online – Universiteti i Arteve</b> KOHA - Integrate Library System <b>JSTOR</b> is a digital library of academic journals, books, and primary sources- "https://about.jstor.org/educators <b>IMSLP – Petruçi Music Library.</b> Papagese - Free Sheet Music PDF - <a href="http://imslp.org/">http://imslp.org</a>		
	<b>Tri Fakultetet – Statistika</b>			
	1.Salla leximi me fonde të hapura - Numri i	<b>Katalogu online – Universiteti i Arteve</b>	1. Statistika nga Google per Katalogun online -	

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr. 2, 1019, Tiranë, Shqipëri. Tel: +355 42 225 488 [www.uart.edu.al](http://www.uart.edu.al)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

përdoruesve: <b>600 përdorues</b>	KOHA - Integrate Library System <b>Rreth 29.000 rekorde tek KOHA</b>	2,119 Përdorues
<b>2. Salla multiediale - 1,312 përdorues</b>	<b>Arkiva Dixhitale - Universiteti I Arteve</b> <a href="http://arkiv.uart.edu.al/">http://arkiv.uart.edu.al/</a> <b>5378 rekorde ne Arkiven Dixhitale</b>	
3.Fondi mbyllur - Numri i përdoruesve me kartelë elektronike: <b>1506</b> (prej të cilëve <b>1250 studentë</b> )	<b>JSTOR</b> is a digital library of academic journals, books, and primary sources- "https://about.jstor.org/educators	2.Statistika nga Google per Arkiven dixhitale . 1,508 përdorues
4.Librat dhe partiturat e huazuara në sistem: <b>9984 njësi.</b>	<b>IMSLP – Petrucci Music Library.</b> Papagese - Free Sheet Music PDF - <a href="http://imslp.org/">http://imslp.org/</a> 500 drama+tekste te dixhitalizuara (Fjala Artistike + Platform Regjizoriale)	Albania
	Burimet e financimit të bibliotekës (donacionet). – 356 libra , 24 periodik; 146 fotokopje shkarkime – për vitin 2024	Biblioteka edhe këtë vite akademik është mbështetur nga donacione,në pasurimin e saj me koleksione fizik.
	Burimet e financimit të bibliotekës (donacionet). – 125 libra, 9 periodik; 96 fotokopje shkarkime – për vitin 2025	

## a) Të dhëna mbi programet e studimit.

Në Universitetin e Arteve ofrohen aktualisht programe studimi të tre cikleve: cikli i parë BSC, cikli i dytë MA, MSC, MP dhe cikli i tretë Doktoratë.

Programet e studimit të ciklit të parë, Bachelor, janë ofruar në institucionin tonë që në fillesat e tij. Duke qënë shumë të hershme, UART nuk disponon për të gjitha programet e studimit Urdhër të Hapjes së këtyre programeve akt ligjor, Vendim të Këshillit të Ministrave apo Urdhër të Ministrisë së Arsimit. Për dy programe studimi ka një akt ligjor të hapjes së tyre, konkretisht me VKM nr. 615, datë 11.06.2009 "Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë në Akademinë e Arteve, në Universitetin "Aleksandër Xhuvani", Elbasan dhe në Universitetin "Fan S. Noli", Korçë", janë hapur 2 (dy) programet e ciklit të parë, DNP në "Pedagogji muzikore" dhe DNP në "Fizarmonikë klasike". Për çdo vit akademik, kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit për të gjithë institucionet e arsimit të lartë, edhe për UART miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM). VKM më e hershme me përfshirjen e 20 (njëzet) programeve të studimit të ciklit të parë të ofruara në FM, 5 (pesë) programeve të studimit të ciklit të parë të ofrura në FAS dhe 2 (dy) programeve të studimit të ciklit të parë, Pikturë dhe Skulpturë, të ofruara në FAB, është me nr. 517, datë 08.08.2007 "Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2007-2008".

Ndërsa VKM e cila pëfshin të gjitha programet e ciklit të parë të ofruara në UART, është ajo me nr. 565, datë 27.06.2013 "Për kuotat e pranimi dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë



*në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë dhe në programet e Integruara të studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2013-2014”.*

I vetmi Urdhër që ka UART për këto programe, është Urdhri i MASH, nr. 76, datë 17.02.2011 *“Për regjistrimin e formës së diplomave “Bachelor” të Akademisë së Arteve, Tiranë”.*

Numrat e identifikimit të diplomave Bachelor janë përcjellë në institucionin tonë me shkresë nga Sekretari i Përgjithshëm i MASH, me nr. 3597/1 Prot., datë 05.07.2011.

Me Urdhër të MASR, nr. 236, datë 19.07.2021, *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Fotografi” në Universitetin e Arteve”*, është hapur programi i studimit Bachelor në “Fotografi”, i cili ofrohet pranë Departamentit të Arteve të Aplikuara të Fakultetit të Arteve të Bukura. Ky program studimi ka mbyllur procesin e akreditimit dhe është vlerësuar me Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA) Nr 33, datë 07.02.2025. Me Urdhër të MAS, nr. 381, datë 08.07.2022 *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Perkusion” në Universitetin e Arteve”*, është hapur programi i studimit Bachelor në “Perkusion”, i cili ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës.

Me Urdhër të MAS, nr. 382, datë 08.07.2022 *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Bachelor” në “Muzikë Jazz” në Universitetin e Arteve”*, është hapur programi i studimit Bachelor në “Muzikë Jazz”, i cili ofrohet pranë Departamentit të Interpretimit të Fakultetit të Muzikës.

Programi i studimit Bsc në “Perkusion” dhe programi i studimit Bsc në “Muzikë Jazz” janë në proces akreditimi. Pritet njoftimi nga ASCAL për Vendimin e Bordit të Akreditimit për vlerësimin e këtyre programeve.

Për të treja programet e studimit (Bsc. në Fotografi; Bsc. në Muzikë Jazz dhe Bsc. në Perkusion) ka përfunduar procesi i regjistrimit të formës së diplomës dhe suplementit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe të trija këto programe janë pajisur edhe me Vërtetimin përkatës ku është përcaktuar numri unik i identifikimit të tyre.

Aktualisht në Universitetin e Arteve ofrohen 35 programe studimi të ciklit të parë, në të tre Fakultetet dhe konkretisht:

- në Fakultetin e Muzikës - 22 (njëzet e dy) programe studimi Bsc;
- në Fakultetin e Arteve të Bukura - 8 (tetë) programe studimi Bsc;
- në Fakultetin e Artit Skenik - 5 (pesë) programe studimi Bsc.

Në përgjigje të kërkesës së bërë nga Fakulteti i Artit Skenik, për fillimin e procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit për herë të parë, programet e studimit të ciklit të parë që ofrohen në këtë fakultet janë në proces të akreditimit. Për një vlerësim sa më të mirë të programeve që ofron, në Fakultetin e Artit Skenik filloi puna në muajin Mars 2025 dhe në bashkëpunim edhe me Sektorin Mësimor u bënë disa ndryshime në Rregulloret e programeve të ciklit të parë, në përputhje me ndryshimet e akteve nënligjore që mbështeten këto rregullore.

Gjithashtu, krahas procesit të vlerësimit në kuadër të akreditimit të këtyre programeve, u përgatit procedura dhe praktika për regjistrimin e formës së diplomës, për të pesë programet e studimit Bsc, sipas Udhëzimit nr. 10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë *“Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.*

Për të pesta programet e studimit (Bsc në Aktrim; Bsc. në Rëgji; Bsc në Skenografi – Kostumografi; Bsc në Koreografi dhe Bsc në Regji Teatri dhe Televizioni) ka përfunduar procesi i regjistrimit të formës së diplomës dhe suplementit nga Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA) dhe këto programe janë pajisur edhe me Vërtetimin përkatës ku është përcaktuar numri unik i identifikimit të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Programet e studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve ofrohen në të tre fakultetet e tij. Këto programe janë hapur me Urdhrin e MASH nr. 397, datë 10.08.2011 “Për hapjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional”, “Master i Shkencave”, “Master i Arteve të Bukura”, në Fakultetin e Muzikës, Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve të Tiranës”.

Sipas këtij Urdhri të MASH janë hapur gjithsej 32 (tridhjetë e dy) programe studimi dhe konkretisht:

- në Fakultetin e Muzikës - 15 (pesëmbëdhjetë) programe studimi Master i Arteve të Bukura, 4 (katër) programe studimi Master Profesional dhe 1 (një) program studimi Master i Shkencave;
- në Fakultetin e Arteve të Bukura – 7 (shtatë) programe studimi Master i Arteve të Bukura;
- në Fakultetin e Artit Skenik - 5 (pesë) programe studimi Master i Arteve të Bukura.

Të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë, janë riorganizuar me:

- Urdhri i MASR nr. 821, datë 26.12.2018 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit të ciklit të dytë në Universitetin e Arteve”, programet Master i Arteve të Bukura u riorganizuan në Master i Arteve duke u ofruar edhe në fushën e Mësuesisë. Në këtë Urdhër u riorganizua edhe programi i studimit Master i Shkencave duke u ofruar edhe në fushën e Mësuesisë.
- Urdhri i MASR Nr. 512, datë 24.10.2019 “Për riorganizimin e disa programeve të studimit në Universitetin e Arteve” u bë riorganizimi i programeve të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, duke u ofruar në fushën e mësuesisë, me kohëzgjatje 2 vite akademike, 120 kredite.

Të gjitha programet e ciklit të dytë që orohen në UART janë të akredituara, proces i cili ka përfunduar me sukses gjatë vitit akademik 2023-2024. Programet Master u vlerësuan nga Bordi i Akreditimit të Arsimit të Lartë me vendime tepër të kënaqshme, konkretisht: 4 (katër) vite akademike për tre programe studimi; 5 (pesë) vite akademike për njëzet e pesë programe studimi dhe 6 (gjashtë) vite akademike për katër programe studimi.

- i) IAL-ja informon mbi të gjitha programet e studimit që ofron, përfshirë ato ndërdisiplinore dhe të përbashkëta, nëse ka. Në raport paraqiten programet e studimit që janë aktive, të pezulluara, të mbyllura, për të cilën/cilat është marrë leje për hapjen e tij/tyre, por nuk është aktivizuar.**

Në Universitetin e Arteve, në tre fakultetet, pjesë përbërëse të tij, ofrohen programe të të tre cikleve:

- në Fakultetin e Muzikës – ofrohen gjithsej 43 (dyzet e tre) programe studimi, nga të cilat 22 (njëzet e dy) programe studimi Bsc, 15 (pesëmbëdhjetë) programe studimi Master i Arteve, 4 (katër) programe studimi Master Profesional dhe 1 (një) program Master i Shkencave dhe 1 (një) program studimi Doktoratë në “Muzikologji”;
- në Fakultetin e Arteve të Bukura - ofrohen gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) programe studimi, nga të cilat 8 (tetë) programe studimi Bsc, 7 (shtatë) programe studimi Master i Arteve dhe 1 (një) program studimi Doktoratë në “Arte Pamore”.
- Në Fakultetin e Artit Skenik - ofrohen gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) programe studimi, nga të cilat 5 (pesë) programe studimi Bsc, 5 (pesë) programe studimi Master i Arteve dhe 1 (një) program studimi Doktoratë në “Arte Skenike”.



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ofrimi i programeve të ciklit të tretë në UART është një risi për institucionin tonë. Pas hapjes së programeve të ciklit të tretë në Fakultetin e Artit Skenik (FAS) dhe në Fakultetin e Muzikës (FM), këtë vit akademik u hap edhe programi i ciklit të tretë në Fakultetin e Arteve të Bukura (FAB). Konkretisht emërtimi i programeve të studimit dhe akti i hapjes së tyre paraqitet sa më poshtë:

- Doktoratë në “Arte Skenike”, ofrohet pranë Fakultetit të Artit Skenik, program studimi i cili është hapur me Urdhër të MAS nr. 127, datë 16.03.2022 *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në “Arte Skenike”, në Universitetin e Arteve të Tiranës”*. Pas plotësimit të rekomandimeve të lëna në Urdhrin e hapjes, programi i studimit u aktivizua në vitin akademik 2022 - 2023. Aktualisht është në vitin e tretë të hapjes së tij.
- Doktoratë në “Muzikologji”, ofrohet pranë Fakultetit të Muzikës, program studimi i cili është hapur me Urdhër të MAS nr. 128, datë 16.03.2022 *“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të*



Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Republika	Programi ndërdisiplinor/të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse po)	Cikli i Programit të Studimit	Jo Aktiv	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.dt. Vendim Bordi për akreditim)	Nr.Akti/Data e miratimit hapjes (ose në proces nëse ka)	Studim tregu (Po / Jo)	
FAKULTETI I MUZIKËS	KMDP	Diplomë Bachelor "Muzikologji"	Nuk janë Programe të përbashkëta apo disipline	po	Cikli i parë		Nr.76, dt.17.02.2011			
	KMDP	Diplomë Bachelor "Dirigjim"			Cikli i parë					
	KMDP	Diplomë Bachelor "Kompozim"			Cikli i parë					
	KMDP	Diplomë Bachelor "Pedagogji Muzikore"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Piano"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Violinë"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Violë"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Violonçel"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Kontrabas"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Flaut"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Oboe"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Fagotë"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Klarinetë"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Korno"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Trombë"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Trombon"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Kitarë"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Fizarmonikë"			Cikli i parë					
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Bastub"			Cikli i parë	x				
	INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Muzikë Jazz"			Cikli i parë					
INTERPRETIM	Diplomë Bachelor "Perkusion"	Cikli i parë			Në proces	Nr.381,dt.08.07.2022				
FAKULTETI I ARTIT SKENIK	KANTO	Diplomë Bachelor "Kanto"			Cikli i parë		Nr.76, dt.17.02.2011			
	AKTRIM DHE TEORI ARTI	Diplomë Bachelor "Aktrim"			Cikli i parë		Në proces			
	REGJI, REGJI FILMI DHE TV	Diplomë Bachelor "Regji"			Cikli i parë		Në proces			
	REGJI, REGJI FILMI DHE TV	Diplomë Bachelor "Regji Filmi dhe Tv"			Cikli i parë		Në proces			
	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI	Diplomë Bachelor Skenografi-Kostumografi			Cikli i parë		Në proces	Nr.76, dt.17.02.2011		
	SKENOGRAFI-KOSTUMOGRAFI	Diplomë Bachelor "Koreografi"			Cikli i parë		Në proces	Nr.565, dt.27.06.2013		
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA	ARTE TË APLIKUARA	Diplomë Bachelor "Pikturë Grafikë"			Cikli i parë					
	ARTE TË APLIKUARA	Diplomë Bachelor "Pikturë Tekstil dhe Modë"			Cikli i parë					
	ARTE TË APLIKUARA	Diplomë Bachelor "Pikturë Multimedia"			Cikli i parë					
	ARTE TË APLIKUARA	Diplomë Bachelor "Fotografi"			Cikli i parë		Nr.33, dt.07.02.2025	Nr.236,dt.19.07.2021		
	PIKTURË	Diplomë Bachelor "Pikturë Monumentale"			Cikli i parë					
	PIKTURË	Diplomë Bachelor "Pikturë Kavaleti"			Cikli i parë			Nr.76, dt.17.02.2011		
	SKULPTURË	Diplomë Bachelor "Skulpturë"			Cikli i parë			Nr.565, dt.27.06.2013		
	SKULPTURË	Diplomë Bachelor "Skulpturë Qeramikë"			Cikli i parë					

- *tretë Doktoratë në "Muzikologji", në Universitetin e Arteve të Tiranës". Programi i studimi u aktivizua në vitin akademik 2022 - 2023. Aktualisht është në vitin e tretë të hapjes së tij.*
- *Doktoratë në "Arte pamore", ofrohet pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, program studimi i cili është hapur me Urdhër të MAS nr. 668, datë 05.12.2023 "Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në "Arte pamore", në Universitetin e Arteve të Tiranës". Programi i studimit, aktualisht është në vitin e parë të hapjes së tij.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për vitin akademik 2024 - 2025, programet e studimit që ofrohen në Fakultetin e Artit Skenik dhe në Fakultetin e Arteve të Bukura janë aktive.

Në Fakultetin e Muzikës, për vitin akademik 2024-2025 nuk pati regjistrime studentësh në 7 (shtatë) programe studimi. Me Vendim të Senatit Akademik (VSA) Nr 10, datë 09.10.2024 “Për miratimin e programeve aktive dhe joaktive të studimit, ë ciklit të parë të studimeve “bachelor” të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2024-2025”, u vendos miratimi i programeve të paaktivizuara të ciklit të parë, në Fakultetin e Muzikës dhe konkretisht: Bsc në Kontrabas; Bsc në Kitarë; Bsc në Oboe; Bsc në Fagot; Bsc në Trombë; Bsc në Trombon dhe Bsc në Bastubë.

Me këtë VSA është njohur edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit me shkresë nga UART.

Në UART nuk ka programe studimi të pezulluara apo të mbyllura.

Në UART nuk ka programe studimi për të cilat është marrë miratimi nga Ministria e linjës për hapjen e tyre dhe të mos jenë aktivizuar.

- ii) IAL-ja informon mbi marrjen e lejes për hapjen e programit të studimit që është në proces vlerësimi, si dhe për programe që ofrojnë formim të vazhdueshëm për të tretë apo për zhvillim profesional të personelit të tyre. Këto të dhëna shoqërohen me numrin dhe datën e aktit për hapjen, për pezullimin ose për mbylljen e programit të studimit.

Tabela nr.7: Mbi programet e studimit që ofrohen në UART, cikli i parë, Bachelor

Programet e ciklit të dytë Master

Fakulteti	Departamenti	Programi i studimit	Programet ndërdisiplinore/të përbashkëta/ që ofrojnë formim për të tretë (nëse ka)	Cikli I Programit të Studimit	Aktiv / Pasiv/ Mbyllur	Akredituar (PO/JO, nëse po, nr.dt. Vendim Bordi për akreditim)	Nr.Akti/Data e miratimit hapjes (ose në proces nëse ka)	Studim tregu (Po / Jo)
FAKULTETI I MUZIKËS	KMDP	MSC në “Muzikologji dhe Mësuesi”	Nuk janë programe të përbashkëta apo disipline	Cikli i dytë	Të gjitha programet e studimit janë	Nr.109, dt.17.05.2024	Nr. 821,dt. 26.12.2018	UART është i vetmi institucion i arsimit të lartë publik që ofron programe në fushën e Muzikës, Arteve të Bukura dhe Artit Skenik.
		MA në “Dirizhim dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.33, dt.12.01.2024		
		MA në “Kompozim dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.106, dt.17.05.2024		
		MP në “Pedagogji Muzikore”		Cikli i dytë		Nr.112, dt.17.05.2024		
	INTERPRETIM	MA në “Piano dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.111, dt.17.05.2024	Nr. 821,dt. 26.12.2018	
		MA në “Violinë dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.127, dt.28.06.2024		
		MA në “Violë dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.125, dt.28.06.2024		
		MA në “Violinçel dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.126, dt.28.06.2024		
		MA në “Kontrabas dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.121, dt.28.06.2024		
		MA në “Flaut dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.36, dt.12.01.2024		
		MA në “Oboe dhe Mësuesi”		Cikli i dytë		Nr.110, dt.17.05.2024		
